



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 15 korrik 2024
Nr. ref.: AGJ 2476/24

AKTGJYKIM

në

rastet e bashkuara nr. KO114/23, KO192/23, KO227/23 dhe KO229/23

Parashtrues

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 4, paragrafit 4 të nenit 432,
dhe paragrafit 2 të nenit 438 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së
Kosovës Nr.08/L-032**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesat janë parashtruar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata referuese) dhe janë nënshkruar nga Kryetari i saj, Fejzullah Rexhepi.

Ligji i kontestuar

2. Gjykata referuese ngre dyshime për kushtetutshmërinë e paragrafit 2 të nenit 4 (Ne Bis In Idem), paragrafit 4 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) dhe paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës Nr.08/L-032 (në tekstin e mëtejme: KPPRK).
3. KPPRK është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 14 korrik 2022 dhe ka hyrë në fuqi më 17 shkurt 2023.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 4 (Ne Bis In Idem), paragrafit 4 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) dhe paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës Nr.08/L-032, të cilat pretendohet se janë në kundërshtim me nenet 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 34 [E drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 8 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 51 (Saktësimi i kërkesës), 52 (Procedura para Gjykatës) dhe 53 (Vendimi) të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 75 (Kërkesa në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës dhe me nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës Nr.01/2018).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës), u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatë

7. Më 2 qershor 2023, Gjykata referuese e dorëzoi kërkesën KO114/23 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 8 qershor 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimeve [Nr. GJR. KO114/23] dhe [Nr. KSH. KO114/23] e caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
9. Më 19 qershor 2023, Gjykata njoftoi për regjistrimin e kërkesës (i) Gjykatën referuese; (ii) Presidentin e Republikës së Kosovës; (iii) Kryeministrin e Republikës së Kosovës; (iv) Avokatin e Popullit; (v) Kryetarin dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës; dhe (vi) Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, të cilëve u dha mundësinë e paraqitjes së komenteve brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të shkresës.

10. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi edhe avokatin e palës së interesuar T.Rr. në rastin KO114/23, të cilit ia dha mundësinë e paraqitjes së komenteve brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të shkresës.
11. Më 5 korrik 2023, Avokati i Popullit kërkoi nga Gjykata që t'i akordohet afat shtesë për dorëzim të komenteve lidhur me vlerësimin kushtetues të dispozitave të kontestuara të KPPRK-së.
12. Më 11 korrik 2023, avokati i palës e interesuar në rastin KO114/23 T.Rr., dorëzoi komente në Gjykatë.
13. Më 18 korrik 2023, Gjykata njoftoi Avokatin e Popullit për miratim të kërkesës për t'i akorduar afat shtesë për dorëzim të komenteve.
14. Më 21 korrik 2023, Gjykata kërkoi nga Gjykata referuese që t'a dorëzojnë vendimin e Kolegjit të Gjykatës referuese për pezullim të çështjes dhe referim të së njëjtit në Gjykatë.
15. Më 31 korrik 2023, Avokati i Popullit dorëzoi komentet lidhur me dispozitat përkatëse të KPPRK.
16. Më 3 gusht 2023, Gjykata referuese dorëzoi vendimin e Kolegjit të Gjykatës referuese për pezullim të çështjes dhe referim të së njëjtit në Gjykatë.
17. Më 1 shtator 2023, Gjykata shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri vendosi t'iu parashtrojë pyetje shteteve anëtare të Komisionit të Forumit të Venecias, si dhe t'a shtyjë shqyrtimin e rastit në seancën e ardhshme pas plotësimit me të dhëna shtesë.
18. Më 18 shtator 2023, Gjykata referuese dorëzoi kërkesë të re, duke kërkuar vlerësim të kushtetutshmërisë të paragrafit 2 të nenit 438 të KPPRK-së. Kërkesa u regjistrua me numër KO192/23.
19. Më 19 shtator 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Urdhrit për bashkim të kërkesave [Urdhri KO114/23 dhe KO192/23] urdhëroi bashkimin e kërkesës KO192/23 me kërkesën KO114/23 për shkak se objekt i vlerësimit është çështja e njëjtë.
20. Më 21 shtator 2023, Gjykata njoftoi për regjistrimin dhe bashkim të kërkesave (i) Gjykatën referuese; (ii) Presidentin e Republikës së Kosovës; (iii) Kryeministrin e Republikës së Kosovës; (iv) Avokatin e Popullit; (v) Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës; dhe (vi) Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, të cilëve u dha mundësinë e paraqitjes së komenteve brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të shkresës.
21. Më 21 shtator 2023, Gjykata iu drejtua shteteve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias me pyetjet si vijon:

“1) A përfshin ligji i aplikueshëm në vendin tuaj mjet të jashtëzakonshëm juridik, përkatësisht kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në rastet që kanë të bëjnë me paraburgim?

2) Nëse vendimi përkatës kundër vendimit të gjykatës të shkallës më të ulët për ndërprerjen e paraburgimit konstaton se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar:

a) a konstaton se vetëm ligji është shkelur, pa ndërhyrë në vendimin përfundimtar, pra, është vendim vetëm i natyrës deklarative; ose

b) është i natyrës ekzekutive, ashtu që i lejon Gjykatës përkatëse që po ashtu ta ndryshojë vendimin e gjykatës të shkallës më të ulët për ndërprerje të paraburgimit në dëm të të pandehurit.”

22. Nga 21 shtatori deri më 23 tetor 2023, Gjykata ka pranuar përgjigje nga Gjykatat Kushtetuese dhe gjykatave me juridiksion kushtetues të shteteve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias siç janë: Shqipëria, Suedia, Lihtenshtajni, Sllovakia, Austria, Çekia, Kazakistani, Kroacia, Turqia, Gjermania, Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë e Hercegovina.
23. Më 17 dhe 18 tetor 2023, Gjykata referuese dorëzoi dy kërkesa të reja duke kërkuar vlerësim të kushtetutshmërisë të paragrafit 2 të nenit 4, paragrafit 4 të nenit 432 dhe paragrafit 2 të nenit 438 të KPPRK-së. Kërkesat u regjistruan me numër KO227/23 dhe KO229/23.
24. Më 20 tetor 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Urdhrit për bashkim të kërkesave [Urdh. KO227/23 dhe KO229/23] urdhëroi bashkimin e kërkesave KO227/23 dhe KO229/23 me kërkesat e bashkuara KO114/23 dhe KO192/23.
25. Më 30 tetor 2023, Gjykata njoftoi për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave (i) Gjykatën referuese; (ii) Presidentin e Republikës së Kosovës; (iii) Kryeministrin e Republikës së Kosovës; (iv) Avokatin e Popullit; (v) Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës; dhe (vi) Zyren e Kryeprokurorit të Shtetit, të cilëve u dha mundësinë e paraqitjes së komenteve brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit të shkresës.
26. Më 1 nëntor 2023, Gjykata shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, dhe në përbërje të plotë njëzëri vendosi ta shtyjë shqyrtimin e rastit në njërën nga seancat e radhës pas plotësimit me të dhëna dhe sqarime shtesë.
27. Më 23 nëntor 2023, Gjykata në përbërje të plotë njëzëri e mbështeti rekomandimin e Gjyqtarit raportues se kërkesa është e pranueshme për shqyrtim dhe po ashtu njëzëri vendosi ta shtyjë shqyrtimin e rastit në njërën nga seancat e radhës pas plotësimit me të dhëna dhe sqarime shtesë.
28. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç’ rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
29. Më 20 mars 2024, Gjykata në përbërje të plotë njëzëri vendosi ta shtyjë shqyrtimin e rastit në njërën nga seancat e radhës pas plotësimit me të dhëna dhe sqarime shtesë.
30. Më 15 maj 2024, Gjykata vendosi (i) njëzëri, se formulimi “ose ndërprerjen” i paragrafit 4 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) të KPPRK-së, nuk është në kundërshtim me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës dhe nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (ii) njëzëri, se paragrafi 2 të nenit 4 (Ne Bis In Idem) të KPPRK-së, nuk është në kundërshtim me nenin 34 [E drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] në lidhje me paragrafin 2 të nenit 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (iii) me pesë (5) vota për dhe katër (4) kundër, se formulimi “përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë” i paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të KPPRK-së, nuk është në kundërshtim me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në

lidhje me paragrafin 2 të nenit 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

31. Në të njëjtën ditë, Gjyqtari raportues në bazë të paragrafit (6) të rregullit 53 (Votimi) të Rregullores së punës, kërkoi nga Kryetarja e Gjykatës që të caktohet një gjyqtar tjetër, nga shumica, për të përgatitur Aktgjykimin.
32. Në të njëjtën ditë, në bazë të rregullit të lartcekur, dhe duke pasur parasysh që anëtarët e tjerë të kolegjit shqyrtues, nuk ishin në mesin e shumicës, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Jeton Bytyqi, për të përgatitur Aktgjykimin sipas konstatimit të Gjykatës.
33. Më 19 qershor 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi prezantoi Aktgjykimin para Gjykatës.
34. Në përputhje me rregullat 56 (Mendimet mospajtuese) dhe 57 (Mendimet konkurruese) të Rregullores së punës të Gjykatës, gjyqtari Radomir Laban ka përgatitur mendim mospajtues dhe konkurrues, i cili do të publikohen së bashku me këtë Aktgjykim.

Përmbledhja e fakteve

35. Në tekstin e mëposhtëm, Gjykata do të pasqyrojë përmbledhjen e shkurtër të sfondit procedural të kërkesave të bashkuara KO114/23, KO192/23, KO227/23 dhe KO229/23, në kohën e dorëzimit të tyre në Gjykatë.

(i) KO114/23 – lidhur me procedurën e paraburgimit

36. Më 28 shkurt 2023, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktvendimit [PKR. Nr. 549/22] e ndërpreu paraburgimin e F.G-së.
37. Prokurori Special i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: PSRK) paraqiti ankesë kundër aktvendimit të lartpërmendur duke pretenduar shkelje të ligjit penal dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
38. Më 1 mars 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN.I.S. nr. 38/2023] e refuzoi të pabazuar ankesën e PSRK-së dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore [PKR.Nr.549/22] të 28 shkurtit 2023.
39. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet e bazuar dhe çështja të kthehet në rivendosije.
40. Mbrojtja e F.G.-së, u përgjigj kundër kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë me propozim që Gjykata Supreme të njëjtën t'a refuzojë të pabazuar ndërsa vendimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit për ndërprerje të paraburgimit të F.G., të vërtetohen.
41. Më 2 qershor 2023, Gjykata Supreme në përputhje me nenin 113 (8) të Kushtetutës dhe nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit, dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 4, paragrafit 4 të nenit 432, dhe paragrafit 2 të nenit 438 të KPPRK-së.

(ii) KO192/23 - lidhur me procedurën e kundërshtimit të provave dhe hedhjes së aktakuzës

42. Më 5 dhjetor 2022, Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, përmes Aktvendimit [P.nr.14/2022], e aprovoi kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhje

të aktakuzës të mbrojtësit të të pandehurit B.M., me ç'rast ishte hedhur aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë [PP.II. nr. 2216/2021] e 21 janarit 2022 dhe kishte pushuar procedurën penale ndaj të pandehurit B.M.

43. Më 10 janar 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN.nr.1353/2022], refuzoi si të pabazuar ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, të 5 dhjetorit 2022.
44. Më 21 qershor 2023, Kryeprokurori i Shtetit paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimeve të lartpërmendura në Gjykatën Supreme duke propozuar anulimin e vendimeve të kontestuara dhe që çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosije.
45. Më 18 shtator 2023, Gjykata Supreme në përputhje me nenin 113 (8) të Kushtetutës dhe nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit, dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 438 të KPPRK-së.

(iii) KO227/23 – lidhur me procedurën e paraburgimit

46. Më 19 gusht 2023, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, përmes Aktvendimit [PPPS. nr. 35/2023], të pandehurve I.L., H.G., dhe R.M., iu kishte caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej një (1) muaji, për shkak të dyshimit të bazuar të kryerjes së veprës penale dhënia e ndihmës në kryerjen e veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, parashikuar me nenin 414 dhe lidhur me nenin 33 të Kodit Penal Nr. 06/L-074 të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshme KPRK).
47. Më 31 gusht 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN.I.S. nr. 165/2023], aprovoi ankesat e mbrojtësve të pandehurve I.L., H.G., dhe R.M., dhe ndryshoi aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që të pandehurve I.L., H.G., dhe R.M., iu ndërprit masa e paraburgimit dhe të njëjtit u liruan menjëherë për t'u mbrojtur në liri.
48. Prokurori i Shtetit paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të procedurës penale me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar dhe çështja të kthehet në rivendosije në gjykatën e shkallës së dytë.
49. Më 18 tetor 2023, Gjykata Supreme në përputhje me nenin 113 (8) të Kushtetutës dhe nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit, dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese lidhur me vlerësimin kushtetues të paragrafit 2 të nenit 4, paragrafit 4 të nenit 432 dhe paragrafit 2 të nenit 438 të KPPRK-së.

(iv) KO229/23 - lidhur me vendimin e formës së prerë me të cilin përfundohet procesi penal

50. Më 31 gusht 2022, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda përmes Aktgjykimit [PKR.nr.15/2020], i shpalli fajtor të pandehurit A.B., O.B., dhe S.B., për kryerje të veprës penale “Krimi i organizuar”, parashikuar me nenin 274 paragrafi 3 i KPRK-së lidhur me veprën penale “Detyrimi”, parashikuar me nenin 267 paragrafi 2 i KPRK-së lidhur me nenin 23 të KPRK-së [...]”. Gjykata vëren se emërtimet e veprave penale të lartcekura korrespondojnë me numrat e neneve të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

51. Më 20 janar 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [APS. nr. 40/2022], e vërtetoi Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë si dhe refuzoi të pabazuar ankesën e Prokurorit Special dhe ankesat e mbrojtësve të të pandehurve A.B., O.B., dhe S.B.
52. Prokurori i Shtetit paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të gjykatave të shkallës më të ulët, duke pretenduar shkelje të dispozitave procedurale penale dhe që për shkak të “gabimeve të rënda” lënda të kthehet në rivendosje. Prokurori i Shtetit kishte kërkuar (i) që të pandehurit të shpallen fajtorë për veprën penale të krimit të organizuar dhe të anulohet veprimi juridik i bartjes së pronës në emër të personave të afërt me të pandehurit; (ii) të konstatohet se vendimet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit përmbajnë shkelje të dispozitave të procedurës penale në favor të të pandehurve; ose (iii) të konstatohet se vendimet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit përmbajnë shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe që për shkak të “gabimeve të rënda”, lënda të kthehet në rivendosje.
53. Më 18 tetor 2023, Gjykata Supreme në përputhje me nenin 113 (8) të Kushtetutës dhe nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese lidhur me vlerësimin kushtetues të paragrafit 2 të nenit 4 dhe paragrafit 2 të nenit 438 të KPPRK-së.

Pretendimet e Gjykatës referuese

54. Në vijim, Gjykata do të pasqyrojë përmbledhjen e shkurtër të pretendimeve të Gjykatës referuese lidhur me të bashkuara KO114/23, KO192/23, KO227/23 dhe KO229/23.
 - (i) *KO114/23 – lidhur me procedurën e paraburgimit*
55. Thelbi i kërkesës së Gjykatës referuese konsiston në dyshimet lidhur me kushtetutshmërinë e paragrafit 2 të nenit 4; paragrafit 4 të nenit 432; dhe paragrafit 2 të nenit 438 të KPPRK-së. Gjykata referuese pretendon se dispozitat përkatëse të KPPRK-së nuk janë në përputhshmëri me nenet 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 34 [E drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.
56. Gjykata referuese pretendon se: *“Sipas kodit të procedurës penale të vitit 2013 (por edhe kodit të procedurës penale që ishte në fuqi deri në vitin 2012) kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë si mjet i jashtëzakonshëm juridik ka mundur të paraqitet vetëm ndaj vendimeve të formës së prerë me të cilat është caktuar dhe vazhduar paraburgimi, kurse tani me kodin e ri edhe ndaj vendimeve të formës së prerë me të cilat është ndërprerë paraburgimi.”*
57. Gjykata referuese po ashtu thekson se: *“Po ashtu sipas kodit të mëparshëm të procedurës penale në kuadër të dispozitës ligjore parimit “ne bis in idem” respektivisht nenit 4 par.2 të KPP me përjashtim të rasteve kur me këtë kod është paraparë ndryshe, vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjetet të jashtëzakonshme juridike vetëm në favor të personit dënuar. Përveç kësaj me kodet e vjetra kur kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë paraqitej në dëm të pandehurit aktgjykimi kishte vetëm karakter deklarativ vetëm konstatohej shkelja pa ndikuar në vendimin e formës së prerë.”*
58. Përkitazi me dispozitat e kontestuara të KPPRK-së, Gjykata referuese thekson se *“[...] sipas dispozitave të kodit të ri të procedurës penale që ka hyrë në fuqi këtë vit aktgjykimi i marrë lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë mund të jetë efektiv dhe deklarativ. Efektiv është në dobi të pandehurit (ndryshimi në dobi ose anulimi), kurse deklarativ kur konstatohet shkelja e ligjit në dobi të pandehurit pa u prekur vendimi i formës së prerë. Por, me dispozitën e kodit të ri të procedurës penale respektivisht par.2 i nenit 4 të KPP parashihet se vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me*

mjete të jashtëzakonshme juridike. Kurse, sipas dispozitës së nenit 438 par.2 të Kodit-kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në dëm të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë.” Lidhur me të lartcekura, Gjykata referuese pretendon se: “[...] përkundër që me kodin e ri është paraparë që kërkesa e paraqitur në dëm të pandehurit ka karakter deklarativ, në të njëjtën kohë është paraparë edhe mundësia e ndryshimit të vendimit të formës së prerë në dëm të pandehurit, pa e përcaktuar efektin juridik të ndryshimit (si mund të ndryshohet aktgjykimi lirues i formës së prerë, në rast se ndryshohet nga ai lirues në dënues a ka të drejtë i pandehuri në ankesë dhe cila gjykatë duhet të vendos lidhur me ankesën, dhe kur një vendim është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë, dhe e njëjta gjë vlen edhe ndaj vendimit të formës së prerë me të cilin është ndërprerë paraburgimi).”

59. Prandaj, Gjykata referuese pretendon se: “Në rastin konkret ndaj aktvendimit të formës së prerë me të cilin i është ndërprerë paraburgimi të pandehurit ka paraqitur kërkesë Prokurori, dhe duke pas parasysh se paraburgimi është masë e sigurisë së pranisë së të pandehurit në procedurën penale, kurse sipas dispozitave të kodit të procedurës penale e drejta për liri dhe siguri duhet të interpretohet në favor të qëndrimit në liri dhe kjo masë (si masë më e rëndë) duhet të reduktohet në kohën sa më të shkurtër të mundshëm pyetja që parashtrohet është se a mund të ndryshohet vendimi i formës së prerë me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si mjet i jashtëzakonshëm juridik në dëm të tij dhe a janë dispozitat e nenit 4 par.2, nenit 432 par.4 dhe 438 par. 2 të Kodit të Procedurës Penale në përputhshmëri me nenin 29 dhe 34 dhe 53 të Kushtetutës së Kosovës.”
60. Gjykata referuese thekson se: “Për arsyet e paraqitura më lartë, konsiderojmë se vendimi meritor i Gjykatës Supreme të Kosovës në rastin konkret është i lidhur drejtpërdrejtë me normat ligjore të cekura më lartë, andaj kjo Gjykatë nuk mund të vendos sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë deri sa Gjykata Kushtetuese të merr vendim lidhur me këtë kërkesë, kurse në Gjykatën Supreme deri në marrjen e vendimit nga Gjykata juaj procedura për vendosje do të suspendohet.”
- (ii) KO192/23 - lidhur me procedurën e kundërshtimit të provave dhe hedhjes së aktakuzës
61. Gjykata referuese thekson se gjyqtarët e degës penale të Gjykatës Supreme të Kosovës, pas takimit kanë vlerësuar se në këtë rast është e nevojshme që të iniciohet procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë para Gjykatës Kushtetuese, pasi që nuk janë të sigurt “nëse dispozita ligjore nga neni 438, paragrafi 2 i KPP-së (që i referohet kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur në dëm të të pandehurit), është në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndërsa një interpretim i tillë është i rëndësishëm për të vendosur në këtë çështje penale”.
62. Gjykata referuese thekson se në dispozitat ligjore të Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale (Kodi nr. 04/L-123, i 13 dhjetorit 2012), njëlloj si në vendet e tjera të rajonit, kishte një zgjidhje të pranueshme ligjore sipas të cilës “Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykim do të vërtetojë se ka shkelje të ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë nëse pranon kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë që është paraqitur në dëm të të pandehurit” (neni 438 paragrafi 2).
63. Gjykata referuese thekson se tani me dispozitën e re ligjore nga neni 438, paragrafi 2 i i KPPRK-së është paraparë që: “Kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në dëm të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e

ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë”.

64. Gjykata referuese konsideron se Gjykata Kushtetuese duhet t'i sqarojë tri (3) gjëra të rëndësishme, si në vijim:
- i. së pari, çfarë nënkuptohet me termin e përdorur nga legjislacioni “*qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*”, pasi kjo mund të shkaktojë paqartësi në interpretim;
 - ii. së dyti, si duhet të veprojë gjykata pasi ka konstatuar se bëhet fjalë për një “*vendim qartazi të papërshtatshëm ose të bazuar në gabim të rëndë*”, pasi kjo nuk sqarohet nga kjo dispozitë ligjore; dhe
 - ii. së treti, kjo mënyrë e vendosjes në dëm të të pandehurit, sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë së Kryeprokurorit të Shtetit, me mjet të jashtëzakonshëm juridik, a është në përputhje me parimet dhe dispozitat kushtetuese, si dhe me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

(iii) *KO227/23 – lidhur me procedurën e paraburgimit*

65. Gjykata referuese thekson se dispozita e KPPRK-së, përkatësisht paragrafi 2 i nenit 4 të KPPRK-së, përcakton se vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete juridike të jashtëzakonshme.
66. Gjykata referuese thekson se “*me kodin e ri është paraparë që kërkesa e paraqitur në dëm të pandehurit ka karakter deklarativ, në të njëjtën kohë është paraparë edhe mundësia e ndryshimit të vendimit të formës së prerë në dëm të pandehurit, pa e përcaktuar efektin juridik të ndryshimit (si mund të ndryshohet aktgjykimi lirues i formës së prerë, në rast se ndryshohet nga ai lirues në dënues, a ka të drejtë i pandehuri në ankesë dhe cila gjykatë duhet të vendos lidhur me ankesën, dhe kur një vendim është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë, dhe e njëjta gjë vlen edhe ndaj vendimit të formës së prerë me të cilin është ndërprerë paraburgimi)*”.
67. Gjykata referuese thekson se: “*në rastin konkret ndaj aktvendimit të formës së prerë me të cilin i është ndërprerë paraburgimi të pandehurit ka paraqitur kërkesë Prokurori, dhe duke pas parasysh se paraburgimi është masë e sigurisë së pranisë së të pandehurit në procedurën penale, kurse sipas dispozitave të kodit të procedurës penale e drejta për liri dhe siguri duhet të interpretohet në favor të qëndrimit në liri dhe kjo masë (si masë më e rëndë) duhet të reduktohet në kohën sa më të shkurtër të mundshme, pyetja që parashtrrohet është se a mund të ndryshohet vendimi i formës së prerë me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si mjet i jashtëzakonshëm juridik në dëm të tij dhe a janë dispozitat e nenit 4 par.2, nenit 432 par.4 dhe 438 par. 2 të Kodit të Procedurës Penale në përputhshmëri me nenin 29 , 34 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.*

(iv) *KO229/23 - lidhur me vendimin e formës së prerë me të cilin përfundohet procesi penal*

68. Gjykata referuese thekson se: “*në rastin konkret ndaj aktvendimit të formës së prerë, përveç mbrojtësve të të pandehurve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kishte ushtruar edhe prokurori i shtetit, duke pasur parasysh se në kërkesë propozoi që për shkak të “gabimeve të rënda” lënda të kthehet në rivendosje, pyetja që parashtrrohet është se a mund të ndryshohet vendimi i formës së prerë me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si mjet i jashtëzakonshëm juridik në dëm të të pandehurve dhe a janë dispozitat e nenit 4 par.2, nenit 432 par.4 dhe 438 par. 2 të KPP-së në përputhshmëri me nenin 30, 31, 34 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.*

Komentet e dorëzuara nga Avokati i Popullit

69. Përkitazi me paragrafin 2 të nenit 438 të KPPRK-së, Avokati i Popullit: “[...] konsideron se në rastin konkret, përderisa një normë nuk e qartëson kur “vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm” dhe kur “vendimi i formës së prerë është i bazuar në gabim të rëndë”, atëherë përcaktimi i papërshtatshmërisë dhe i gabimit të rëndë bie në diskrecion të gjyqtarëve, gjë që rezulton me vendosje arbitrare të tyre.”
70. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit shton se: “[...] është e papranueshme që veprimet procedurale të bazohen në një normë e cila nuk e përcakton qartë se kur një vendim i formës së prerë është i papërshtatshëm, apo kur është i bazuar në gabim të rëndë. Normat procedural duhet të jenë të qarta dhe të parashikueshme, në mënyrë që palët në procedurë të mund t’i zhvillojnë dhe t’i parashikojnë veprimet e tyre procedurale në drejtim të realizimit të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave”.
71. Avokati i Popullit thekson se paragrafi 2 i nenit 438 të KPPRK-së, nuk i përmban elementet e nevojshme të sundimit të ligjit siç janë siguria juridike dhe ndalimi i arbitraritetit të përcaktuara nga Komisioni i Venecias.
72. Në vijim, Avokati i Popullit duke iu referuar Komisionit të Venecias konsideron se: “elementet e nevojshme të sundimit të ligjit, si: ligjshmëria, siguria juridike, ndalimi i arbitraritetit, respektimi i të drejtave të njeriut dhe mos diskriminimi dhe barazia para ligjit, nuk duhet të jenë vetëm formale, por edhe thelbësore në përmbushjen dhe funksionimin e shtetit të së drejtës”.
73. Avokati i Popullit specifikon se: “Përmbajtja aktuale e nenit 438 paragrafi 2, të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale në Kosovë është e paqartë dhe nuk përmban elementet e sundimit të ligjit dhe nuk është në harmoni me elementet e sundimit të ligjit të përcaktuara nga Komisioni i Venecias”.
74. Bazuar në shtjellimin e mësipërm, Avokati i Popullit e konsideron shumë të rëndësishme që Gjykata të vlerësojë nëse paragrafi 2 i nenit 438 të KPPRK-së cenon sigurinë juridike, pozicionin e të pandehurit në procedurën penale si dhe nëse i njëjti është në përputhje me elementet e sundimit të ligjit.

Komentet e dorëzuara nga T.Rr në cilësi të avokatit të palës së interesuar F.G.

75. T.Rr., në cilësi të avokatit të palës së interesuar F.G., specifikon se sa i përket çështjes së paraburgimit, kjo çështje nuk ndërlihet me parimin *Ne Bis In Idem* pasi “nuk është e përshtatshme për rastin konkret, sepse Neni 4 i KPPRK-së i referohet rasteve kur personi është dënuar apo është liruar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës.” Për më tepër, sipas tij, në rastin e F.G. kemi të bëjmë me rast kur ky i fundit, “nuk është në gjendje të përballet me shqyrtimin gjyqësor për shkak të sëmundjes mendore e cila është e karakterit të përhershëm.” Megjithatë, ai ngrit dyshimin mbi kushtetutshmërinë e kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimit të formës së prerë mbi ndërprerjen e paraburgimit, si mjet juridik para Gjykatës Supreme, dhe përputhshmërisë së kësaj dispozite me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ). Për më tepër, ai po ashtu thekson sa i përket paragrafit 2 të nenit 438 të KPPRK-së se “[...] Fjalët e përdorura në këtë dispozitëpërveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë janë krejtësisht të paqarta, të pakuptueshme dhe abstrakte, dhe krijojnë pasiguri juridike.” Ai shton më tej se përkitazi me paraburgimin se “[...] kushtet për heqjen e lirisë sipas ligjit të brendshëm të përcaktohen qartë dhe që vet ligji të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që

të përmbushet standardi i "ligjshmërisë" i vendosur nga" KEDNJ duke cituar përkitazi me këtë edhe rastet e GJEDNJ-së, përfshirë rastin, [Baranowski kundër Polonisë](#).

Kontributi i Shteteve Anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias

Shqipëria

76. Kodi procedural penal shqiptar nuk parashikon mjetin e jashtëzakonshëm juridik, përkatësisht kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Një dispozitë e tillë ishte bërë pjesë përbërëse e sistemit juridiko-ligjor në vitin 1996, por që më vonë ishte shpallur kundërkushtetues përmes vendimit nr. 55 të 21 nëntorit 1997. Vendimi nr. 55 i 21 nëntorit 1997 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në pjesën relevante përcakton: *"Me propozim të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Gjykata Kushtetuese me nismën e saj, ashtu si për çështjet e tjera të ngritura në kërkesën e tij, ia nënshtroi kontrollit konstitucional edhe ligjet nr.8180 e nr.8181, datë 23.12.1996 që bëjnë fjalë, i pari "Për një ndryshim në Kodin e Procedurës Penale" dhe tjetri po "Për një ndryshim në Kodin e Procedurës Civile. Në të dy këto ligje është parashikuar të krijohet një institut i ri, i cili i jep të drejtë Prokurorit të Përgjithshëm të ushtrojë rekurs në interes të ligjit për prishjen e vendimeve të formës së prerë të gjykatës së shkallës së parë, gjykatës së apelit si edhe vendimeve të Kolegjit Penal dhe Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit. Gjykata Kushtetuese duke shqyrtuar thelbin dhe përmbajtjen e këtyre akteve normative dhe duke i krahasuar e analizuar ato në frymën e ligjeve kushtetuese, çmon se pajisja e Prokurorit të Përgjithshëm me këtë mjet të ri reagimi si dhe e drejta e tij për ta përdorur atë brenda një viti nga dita që vendimet e këtyre gjykatave kanë marrë formën e prerë, nuk pajtohet me funksionet dhe detyrat kushtetuese të organit të prokurorisë. Në bazë të nenit 13 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", Prokuroria është autoriteti i vetëm që ushtron ndjekjen penale në hetim dhe në gjyq dhe që në veprimtarinë e saj gjyqësore mbron interesat e përgjithshme të shoqërisë, të rendit juridik si dhe të drejtat e liritë e shtetasve. Nga kjo del se me formën e re të organizimit të sanksionuar në këtë dispozitë kushtetuese, prokuroria nuk është e veshur me funksionin e kontrollit mbi ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Veprimtaria dhe sfera e kompetencave të saj është më e kufizuar dhe përqëndrohet kryesisht në hetim, ndërsa në gjykimin e çështjeve penale e civile, kompetencat e prokurorit ushtrohen vetëm gjatë kohës që është në vazhdim ose porsa ka përfunduar procesi gjyqësor, por kurdoherë brenda afateve të përcaktuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe të Kodit të Procedurës Civile. Për më tepër, në gjykimin e çështjeve penale e civile, preket edhe parimi i barazisë së palëve e sanksionuar nga neni 25 të ligjit nr.7692, datë 31.03.1993 për "Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut."*

Suedia

77. Gjykata Supreme e Suedisë u përgjigj se në sistemin juridik suedez nuk ekziston mjeti i jashtëzakonshëm juridik, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë. Gjykata Supreme e Suedisë shpjegon se rastet e paraburgimit, në praktikë, gjithmonë kontestohen me mjete të zakonshme juridike. Nëse më vonë shfaqen rrethana të reja, për shembull, gjatë fazës paraprake hetimore, çështja e paraburgimit mund të rivlerësohet. Kjo mund të shpie tek lirimi i të paraburgosurit, ose-nëse i dyshuari është i arratisur-një kërkesë nga prokurori për paraburgimin e të dyshuarit. Gjykata, në një situatë të tillë, nuk do të kushtëzohej nga vendimet paraprake lidhur me çështjen e paraburgimit. Prandaj, në praktikë, nuk është me vend të thuhet që paraburgimi është përfundimtar sikurse është referuar në pyetjen e parashtruar. Së fundi, vlen të theksohet se gjykatat sikurse edhe prokurorët janë të kushtëzuar nga parimi i proporcionalitetit ashtu që paraburgimi të jetë sa më i shkurtër që është e mundur.

Lihtenshtajni

78. Kodi i Procedurës Penale të Lihtenshtajnit parashikon mjet të zakonshëm juridik për Prokurorin e Shtetit në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit lidhur me ndërprerjen e paraburgimit të pandehurit. Neni 240, paragrafi 1, pika 2 e KPP-së thekson si në vijim: “*Kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën Supreme në këto raste: 2. nga prokurori kundër vendimeve me të cilat refuzohet kërkesa për iniciimin e hetimit, urdhri për arrest, caktimi ose vazhdimi i paraburgimit ose shqiptohet ndërprerja*”. Një ankesë të tillë mund ta ushtrojë gjithashtu edhe i pandehuri, konkretisht në rast se refuzohet ankesa e tij kundër caktimit ose vazhdimit të paraburgimit (neni 240 paragrafi 1 pika 1a e KPP-së). Megjithatë, një mjet juridik i jashtëzakonshëm i ngjashëm me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, nuk ekziston në Lihtenshtajn. Pasi që prokurori i shtetit ka në dispozicion mjet të zakonshëm juridik, Gjykata Supreme mund ta ndryshojë vendimin e Gjykatës së Apelit.

Sllovakia

79. Në sistemin juridiko-ligjor të republikës sllovaqe, vendimi përfundimtar për paraburgim mund të kontestohet vetëm përmes ankesës për çështje të ligjit (*points in law*) të parashtruar nga Ministri i Drejtësisë i Republikës sllovaqe. Ankesat për çështje të ligjit në procedurat penale shqyrtohen nga Gjykata Supreme e Republikës sllovaqe. Kur vendos për ankesa për çështje të ligjit, Gjykata Supreme mund t'i anulojë vendimet e kontestuara dhe të njëjtat t'i kthej tek gjykatat e instancës më të ulët, të cilat janë të lidhura për vendimet e Gjykatës Supreme. Nëse kërkohet nga Ministri i Drejtësisë, Gjykata Supreme po ashtu mund t'i anulojë vendimet për paraburgim të nxjerra në dobi të të pandehurve. Kushtetutshmëria e kornizës ligjore të lartpërmendur asnjëherë nuk është kontestuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës sllovaqe.

Austria

80. Sipas kodit të procedurës penale të Austrisë, Prokurori i Përgjithshëm duke vepruar me vetiniciativë ose me kërkesë të Ministrisë Federal të Drejtësisë, mund të paraqesë ankesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Ankesa e tillë mund të paraqitet kundër çdo aktgjykimi, aktvendimi apo mase tjetër të gjykatës penale. Ankesa mund të paraqitet në çdo kohë, pra, edhe kur është përfundimtare dhe pavarësisht nga fakti nëse palët në procedurë penale kanë përdorur mjet juridik. Në parim, ankesa e tillë po ashtu mund të paraqitet kundër vendimeve të gjykatave lidhur me paraburgim. Nëse ankesa është e bazuar, Gjykata Supreme do të konstatojë se ka pasur shkelje të ligjit. Në parim, ky vendim është i karakterit deklarativ dhe nuk i prek të drejtat e të akuzuarit. Megjithatë, nëse vendimi i gjykatës shqipton dënim, Gjykata Supreme bazuar në diskrecionin e saj mundet ta lirojë të akuzuarin, zvogëlojë dënimin ose të urdhërojë përsëritjen e procedurës. Sido që të jetë, vendimi i gjykatës asnjëherë nuk mund të ndryshohet në dëm të të akuzuarit.

Çekia

81. Sistemi juridik i republikës çeke nuk parashikon mjet të jashtëzakonshëm juridik siç është kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.

Kazakistani

82. Kategoria e ankesave për mbrojtje të ligjshmërisë nuk janë shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kazakistanit.

Kroacia

83. Në sistemin juridik kroat ekziston mjete i jashtëzakonshëm kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Prokurori i Shtetit mund të paraqesë kërkesë kundër vendimit përfundimtar

të gjykatës, përfshirë vendimin për paraburgim i nxjerrë në procedurë që është përfshirë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me kushtetutë si dhe me të drejtën vendore dhe ndërkombëtare. Kur gjykata konstaton se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar, ajo nxjerrë aktgjykim me ç'rast konstaton, varësisht nga natyra e shkeljes ligjore, ose ta kthejë vendimin përfundimtar në rigjykim ose të njëjtin e prish në tërësi ose pjesërisht. Nëse kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është parashtruar në dëm të të pandehurit dhe gjykata konstaton se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar, e njëjta vetëm konstaton se ekziston shkelja e ligjit, por pa ndikuar në vendimin përfundimtar. Gjykata ndonjëherë nxjerrë vendime deklarative edhe në rastet kur kërkesa është paraqitur në dobi të të pandehurit ose në rast të shkeljes së ligjit në dëm të të pandehurit, respektivisht, ose nëse gjykata vlerëson se nuk është e nevojshme, për shkak të rëndësisë së vogël të shkeljes së kryer, të kthejë ose prish vendimin ashtu që të korrigjohet shkelja në procedurën e përsëritur.

Turqia

84. Në sistemin turk të drejtësisë penale, Prokurori i Shtetit nuk e ka mundësinë e paraqitjes së ankesës së jashtëzakonshme në Gjykatën e Kasacionit për ta mbrojtur ligjshmërinë e vendimeve përfundimtare të gjykatave të instancës më të ulët lidhur me ndërprerjen e paraburgimit të personit të akuzuar. Prokurori i Shtetit ka vetëm mundësinë që ta kërkojë paraburgimin e të pandehurit, ose që të jep opinionin e tij në zgjatjen ose ndërprerjen e paraburgimit, apo edhe të paraqes kundërshtim ndaj urdhrit për paraburgim tek gjyqtari kompetent gjatë gjithë fazave të zhvillimit të procedurës penale sipas mënyrës së parashikuar me ligjin procedural penal.

Gjermania

85. Ligji i zbatueshëm në Gjermani nuk përmban mjet të jashtëzakonshëm juridik që korrespondon me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në rastet që ndërlidhen me paraburgim. Nëse gjykata vendos ta revokojë apo pezullojë një urdhër arresti që imponon paraburgim, prokurori publik mund të paraqes ankesë kundër urdhrit të gjykatës. Gjykata që vendos sipas ankesës mund të rivendos urdhër arrestin përveç nëse arsyeja për ndërprerje të paraburgimit është lirimi i të akuzuarit. Duke vepruar ashtu, gjykata po ashtu mund ta bazoj urdhër-arrestin mbi baza të ndryshme ose dyshimin e fortë se i akuzuari ka kryer një vepër tjetër penale. Sido që të jetë, ankesa përbën mjet të zakonshëm juridik. Derisa e drejta procedurale gjermane i njeh disa mjete të jashtëzakonshme juridike siç janë restaurimi i *status quo ante* pas dështimit për t'i respektuar afatet, dhe disa prej tyre shërbejnë për mbrojtje të ligjshmërisë, ato kufizohen në vendime të procedurës së çështjes kryesore dhe se nuk i mundësojnë prokurorit publik që të kontestojë vendimet e gjykatave lidhur me ndërprerjen e paraburgimit.

Maqedonia e Veriut

86. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është mjet i jashtëzakonshëm juridik që mund të paraqitet nga prokurori publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut kundër vendimeve përfundimtare në rast se janë në kundërshtim me kushtetutën, ligjin apo marrëveshjen ndërkombëtare të ratifikuar në pajtim me kushtetutën. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut e cila vendos në seancë gjyqësore. Nëse kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është parashtruar kundër të akuzuarit dhe gjykata konstaton se është e bazuar, e njëjta vetëm do të konstatojë se ligji është shkelur por nuk do të ndërhyjë në vendimin përfundimtar.

Bosnjë dhe Hercegovina

87. Ekzistojnë katër ligje të procedurës penale në Bosnje dhe Hercegovinë. Një në nivel shtetëror, dy në nivel të etnive dhe një në nivel të Qarkut të Brçkos. Vetëm njëri prej tyre

parashikon kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si mjet i veçantë i jashtëzakonshëm juridik, kodi i procedurës penale të Republika Srpska. Neni 350 i këtij kodi parashikon paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimit përfundimtar. Ky ligj nuk parashikon përjashtime të ngjashme me dispozitën e paragrafit 4 të nenit 432 të Kodit të procedurës penale të Republikës së Kosovës.

Dispozitat përkatëse Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 29

[E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]

“1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

(1) pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;

(2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;

(3) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm;

(4) për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë;

(5) për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim.

2. Çdokush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsyet e privimit, në gjuhën që ajo/ai e kupton. Njoftimi me shkrim mbi arsyet e privimit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundshme. Çdokush që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës. Çdokush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit.

3. Çdokush që privohet nga liria, duhet të njoftohet menjëherë se ka të drejtë të mos japë asnjë deklaratë dhe se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së tij/saj dhe ka të drejtë që pa vonesë të informojë për këtë personin sipas zgjedhjes së vet.

4. Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit.

5. Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj.

6. Personi që vuan dënimin, ka të drejtë të ankohet për kushtet e privimit nga liria, në mënyrën e përcaktuar me ligj.”

Neni 34
[E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër]

“Askush nuk mund të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale.”

Neni 103
[Organizimi dhe Jurisdiksioni i Gjykatave]

“1. Organizimi, funksionimi dhe jurisdiksioni i Gjykatës Supreme dhe i gjykatave të tjera, rregullohen me ligj.

2. Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor.
[...]

Neni 109
[Prokurori i Shtetit]

“1. Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj.

2. Prokurori i Shtetit është institucion i paanshëm, dhe vepron në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit.

3. Organizimi, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit rregullohen me ligj.

4. Prokurori i Shtetit pasqyron përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe respekton parimet e barazisë gjinore.

5. Mandati fillestar për prokuror është trevjeçar. Në rast të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, sikurse është përcaktuar me ligj, përveç nëse shkarkohet në pajtim me ligjin.

6. Prokurorët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave.

7. Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatëvjeçarë, pa mundësi riemërimi.”

Neni 53
[Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 5 (E drejta për liri dhe siguri)

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

a. kur burgoset ligjërisht pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;

b. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji;

c. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t’u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një vepër penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

d. kur një i mitur ndalohet ligjërisht për qëllim edukimi të mbikqyrur ose për ndalimin e tij të ligjshëm me qëllim që të çohet përpara autoritetit kompetent ligjor;

e. kur ndalohet ligjërisht për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, të personave të sëmurë mendërisht, alkoolistëve, narkomanëve ose endacakëve;

f. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e paautorizuar në atë vend, ose nëse kundër tij është duke u kryer një procedurë dëbimi ose ekstradimi;

2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet.

3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni duhet të çohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t’u paraqitur në procesin gjyqësor.

4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirinë, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.

5. Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim.”

Protokolli nr.7 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore

Neni 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë)

“1. Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksioni i të njëjtit Shtet për një vepër për të cilën ai më parë ka qenë shpallur i pafajshëm ose dënuar me një

vendim gjyqësor përfundimtar, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij Shteti.

2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit të interesuar, në rast se fakte të reja ose të zbuluara rishtazi, ose një mangësi themelore në procedimet e mëparshme janë të një natyre të tillë që mund të cenojnë vendimin e dhënë.

3. Asnjë derogim nuk lejohet për këtë nen në përputhje me nenin 15 të Konventës.”

Kodi nr.08/L-032 Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

Neni 3

Prezumimi i pafajësisë së të pandehurit dhe In Dubio Pro Reo

“1. Çdo person i dyshuar ose që akuzohet për veprë penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës.

2. Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.”

Neni 4

Ne Bis In Idem

“1. Askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për veprë penale për të cilën është liruar ose për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, përkatësisht nëse procedura penale kundër tij është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës.

2. Me përjashtim të rasteve kur me këtë Kod është paraparë ndryshe, vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike.

3. Nenet 1 dhe 2 të Kodit Penal zbatohen përshtatshmërisht.”

Neni 171

Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit

“1. Masat të cilat mund të përdoren për të siguruar praninë e të pandehurit, për pengimin e rikryerjes së veprës penale dhe për zbatimin e suksesshëm të procedurës penale janë:

- 1.1. thirrja;*
- 1.2. urdhërarresti;*
- 1.3. premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin;*
- 1.4. ndalimi për t’iu afruar vendit ose personit të caktuar;*
- 1.5. paraqitja në stacionin policor;*
- 1.6. dorëzania;*
- 1.7. arresti shtëpiak;*
- 1.8. paraburgimi.*

2. Me rastin e vendosjes se cilën nga masat do ta zbatojë për të siguruar praninë e të pandehurit, gjykata detyrohet t’i merr parasysh kushtet e përcaktuara për masat konkrete dhe të sigurojë që të mos zbatojë masë më të rëndë kur mjafton masa e butë.

3. Këto masa hiqen kur pushojnë shkaqet që i kanë shkaktuar, apo zëvendësohen me masa të tjera më të buta po qe se për këtë plotësohen kushtet.

4. Para ngritjes së aktakuzës vendimet lidhur me këto masa i merr gjyqtari i procedurës paraprake, kurse pas ngritjes së aktakuzës vendimet i merr gjyqtari i vetëm apo kryetari i trupit gjykues, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë Kod.

5. Shprehja “masë më e butë për të siguruar praninë e të pandehurit” apo “masa më të buta” për qëllim të këtij kodi nënkupton thirrjen, premtimin e të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi për t’iu afruar vendit ose personit të caktuar, paraqitjen në stacionin policor, dorëzimin dhe arrestin shtëpiak.

6. Gjykata mund të shqiptojë njëkohësisht një apo më shumë masa nga paragrafi 1 i këtij neni.”

Nënkapitulli V - Mjetet e jashtëzakonshme juridike

Neni 419

Mjetet e jashtëzakonshme juridike

“1.Procedura penale e përfunduar me aktvendim të formës së prerë ose me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet me kërkesën e personave të autorizuar vetëm në rastet dhe sipas kushteve të parapara me këtë Kod. Kërkesa për rishikim të procedurës penale i paraqitet gjykatës themelore e cila ka nxjerr vendimin.

2. Pala mund të kërkojë zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit në çdo kohë gjatë periudhës së mbajtjes së dënimit. Pala i paraqet kërkesën gjykatës themelore e cila ka nxjerr aktgjykimin në shkallë të parë, e cila ia përcjell të gjitha shkresat e lëndës Gjykatës Supreme.

3. Pala mund të paraqesë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre (3) muajsh nga dita kur është dorëzuar aktgjykimin i formës së prerë ose aktvendimi i formës së prerë kundër të cilit kërkohet mbrojtja e ligjshmërisë. Pala paraqet kërkesën në gjykatën themelore e cila ka nxjerr vendimin në shkallë të parë, e cila ia përcjell të gjitha shkresat e lëndës Gjykatës Supreme.

4.Nenet 375, 376, 377, 378 dhe 379 të këtij Kodi zbatohen për të gjitha kërkesat nga ky nen.”

Kërkesa për rishikimin e procedurës penale

Neni 422

Rishikimi i procedurës penale të pushuar me aktvendim të formës së prerë

“1. Procedura penale e pushuar në formë të prerë para fillimit të shqyrtimit gjyqësor mund të rishikohet kur prokurori i shtetit tërhiqet nga aktakuza dhe vërtetohet se tërheqja është pasojë e veprës penale të kryer nga prokurori i shtetit. Gjatë provimit të veprës penale zbatohen dispozitat nga neni 423, paragrafi 3 i këtij Kodi.

2. Kur aktakuza hidhet bazuar në mungesë provash të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale të përshkruar në aktakuzë dhe nëse zbulohen dhe mblidhen fakte dhe prova të reja, mund të ngritet aktakuzë e re kur kolegji shqyrtues vendos se provat dhe faktet e reja e arsyetojnë këtë.”

Neni 423

Rishikimi i procedurës penale të përfunduar me aktgjykim të formës së prerë

“1. Procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet vetëm nëse:

1.1. provohet se aktgjykimi është mbështetur në dokument të falsifikuar ose në deklaram të rremë të dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit;

1.2. provohet se aktgjykimi është pasojë e veprës penale të kryer nga gjyqtari ose personi që ka ndërmarrë veprimet hetimore;

1.3. zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja, të cilat vetë ose së bashku me provat e mëparshme ka të ngjarë të arsyetojë pafajësinë e personit të dënuar ose dënimin e tij sipas një dispozite më të butë penale;

1.4. personi për të njëjtën vepër është gjykuar disa herë ose kur disa persona janë dënuar për vepër të njëjtë të cilën ka mund ta kryejë vetëm një person ose disa prej tyre; ose

1.5. në rastin e dënimit për vepër penale në vazhdim ose vepra tjera penale të cilat sipas ligjit përfshijnë disa veprime të njëjta ose të ndryshme, zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja që tregojnë se i dënuari nuk ka kryer veprimin që është përfshirë në veprën penale për të cilën ai është dënuar dhe ekzistimi i fakteve të tilla do të ishte me ndikim vendimtar në caktimin e dënimit.

2. Procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet vetëm në favor të të pandehurit, përveç nëse vërtetohet që rrethanat nga paragrafi 1 nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2 të këtij neni janë pasojë e veprës penale të kryer nga i pandehuri ose personi që vepron në emër të tij kundër një dëshmitari, eksperti, përkthyesi, prokurori të shtetit ose gjyqtari apo të afërmve të tyre, me ç’rast procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet kundër të pandehurit. Rishikimi i procedurës penale në dëm të pandehurit lejohet vetëm brenda pesë (5) vjetëve nga koha e shpalljes së aktgjykimit të formës së prerë.

3. Në rastet nga paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 dhe 1.2 ose paragrafit 2 i këtij neni, me aktgjykim të formës së prerë duhet vërtetuar se personat e tillë a janë shpallur fajtor për veprat penale përkatëse. Kur procedura kundër këtyre personave nuk mund të zbatohet për shkak se kanë vdekur ose ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, faktet nga paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe 1.2 ose paragrafi 2 i këtij neni mund të vërtetohen edhe me prova të tjera.”

Neni 424

Personat e autorizuar për të kërkuar rishikimin e procedurës penale

“1. Rishikimin e procedurës penale mund ta kërkojnë palët dhe mbrojtësi. Pas vdekjes së të dënuarit, rishikimin mund ta kërkojë prokurori i shtetit, bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor, personi në gjini gjaku në vijë direkte deri në shkallë të parë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra ose prindi birësues i të dënuarit.

2. Rishikimi i procedurës penale mund të kërkohet edhe pasi i dënuari mban dënimin, pavarësisht nga afati i parashkrimit, amnistisë ose faljes.

3. Kur gjykata kompetente për të vendosur mbi rishikimin e procedurës penale mëson se ekzistojnë shkaqe për rishikimin e procedurës penale, për këtë e njofton të dënuarin apo personin e autorizuar për paraqitje të kërkesës.”

Neni 425

Përmbajtja e kërkesës për rishikim të procedurës penale dhe gjykata që vendos për të

“1. Kërkesa për rishikimin e procedurës penale vendoset nga kolegji shqyrtues i gjykatës themelore e cila ka gjykuar në procedurën e mëparshme.

2. Në kërkesë duhet shënuar bazën ligjore sipas së cilës kërkohet rishikimi, si dhe provat me të cilat argumentohen faktet në të cilat mbështetet kërkesa. Nëse kërkesa nuk i përmban këto të dhëna, gjykata e thërret parashtruesin që brenda afatit të caktuar të plotësojë kërkesën.

3. Me rastin e vendosjes së kërkesës për rishikim, në kolegji nuk merr pjesë gjyqtari i cili ka marrë pjesë në marrjen e aktgjykimit në procedurën e mëparshme.”

Neni 426

Baza dhe procedura për hedhjen e kërkesës për rishikim të procedurës penale

“1. Gjykata me aktvendim hedh kërkesën kur në bazë të saj dhe shkresave të procedurës së mëparshme vërteton se:

1.1. kërkesën e ka parashtruar personi i paautorizuar;

1.2. nuk ka bazë ligjore për rishikim të procedurës;

1.3. faktet dhe provat në të cilat mbështetet kërkesa janë paraqitur në kërkesën e mëparshme për rishikim të procedurës e cila është refuzuar me aktvendim të formës së prerë;

1.4. faktet dhe provat nuk ofrojnë arsye për lejim të rishikimit të procedurës; ose

1.5. parashtruesi i kërkesës për rishikim të procedurës nuk ka vepruar sipas nenit 425, paragrafi 2 të këtij Kodi.

2. Kur gjykata nuk e hedh kërkesën, kopja e kërkesës i dërgohet prokurorit të shtetit ose palës tjetër, e cila ka të drejtë që brenda tetë (8) ditëve të përgjigjet në kërkesë. Pasi gjykata të merr përgjigje në kërkesë ose kur kalon afati për paraqitjen e përgjigjes, kryetari i kolegjit shqyrtues urdhëron gjurmimin dhe shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura në kërkesë dhe në përgjigje.”

Neni 427

Vendimet e kolegjit lidhur me kërkesën për rishikim

“1. Bazuar në rezultatet e gjurmimit dhe shqyrtimit të fakteve dhe provave të paraqitura në kërkesë dhe në përgjigje, gjykata aprovon kërkesën dhe lejon rishikimin e procedurës penale ose e refuzon kërkesën.

2. Kur gjykata çmon se shkaqet për të cilat ka lejuar rishikimin e procedurës janë edhe në dobi të një të bashkakuzuari i cili nuk ka paraqitur kërkesë për rishikim të procedurës, vepron sipas detyrës zyrtare sikur kërkesa e tillë të ishte paraqitur.

3. Në aktvendim me të cilin lejohet rishikimi i procedurës penale, gjykata urdhëron caktimin e menjëhershëm të shqyrtimi të ri gjyqësor ose kthimin e çështjes në fazën e hetimit, apo fillimin e hetimit kur hetimi nuk është zbatuar më parë.

4. Gjykata urdhëron që ekzekutimi i aktgjykimit të shtyhet ose të ndërpritet nëse duke u bazuar në provat e paraqitura çmon se:

4.1. i dënuari në procedurë të përsëritur mund të dënohet me dënim të tillë që pas llogaritjes së dënimit të mbajtur do të duhej të lirohet;

4.2. ai mund të lirohet nga akuza; ose

4.3. akuza e ngritur kundër tij mund të refuzohet.

5. Kur aktvendimi me të cilin lejohet rishikimi i procedurës penale merr formë të prerë, atëherë pushohet ekzekutimi i dënimit. Por, nëse ekzistojnë kushtet nga neni 184 paragrafi 1 i këtij Kodi, gjykata cakton paraburgimin.”

Neni 428 **Rregullat për procedurën e re të rishikimit**

“1. Për procedurën e re që zbatohet në bazë të aktvendimit me të cilin lejohet rishikimi i procedurës penale vlejnë dispozitat e njëjta si ato të procedurës së mëparshme. Në procedurën e re, gjykata nuk detyrohet me aktvendimet e marra në procedurën e mëparshme.

2. Në qoftë se procedura e re pushohet para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, aktgjykimi i mëparshëm anulohet me aktvendimin mbi pushimin e procedurës.

3. Me rastin e marrjes së aktgjykimit të ri, gjykata anulon aktgjykimin e mëparshëm apo vetëm një pjesë të tij, ose e lë në fuqi aktgjykimin e mëparshëm. Në dënim të shqiptuar me aktgjykim të ri, gjykata i llogarit të akuzuarit dënimin e mbajtur, e kur lejohet rishikimi vetëm për ndonjë vepër për të cilën i akuzuari ka qenë i dënuar ose i liruar, gjykata shqipton dënim të ri unik sipas dispozitave të Kodit Penal.

4. Gjykata në procedurën e re detyrohet me ndalesën e paraparë në nenin 395 të këtij Kodi.”

Neni 432 **Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë**

“1. Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet vijuese:

1.1. në rast të shkeljes së ligjit penal;

1.2. në rast të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1 i këtij Kodi; ose

1.3. në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, as kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, Kryeprokurori i Shtetit mund të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për cilëndo shkelje ligjore.

4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet, gjatë procedurës e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.”

Neni 438 **Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë**

“1. Kur Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, merr aktgjykim me të cilin, duke pasur parasysh llojin e shkeljes:

1.1. ndryshon vendimin e formës së prerë;

1.2. në tërësi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë ose vetëm vendimin e gjykatës më të lartë dhe lëndën për vendim të ri mbi meritat ose për rigjykim ia kthen gjykatës themelore ose gjykatës më të lartë; ose

1.3. kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit.

2. Kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë.

3. Kur Gjykata e Apelit sipas këtij Kodi nuk ka pasur të drejtë ta mënjanojë shkeljen e ligjit e cila është bërë me vendim të shkallës së parë ose në procedurë gjyqësore që i ka paraprirë atij vendimi dhe Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa e paraqitur në dobi të të akuzuarit është e bazuar dhe se për mënjanimin e asaj shkelje duhet anuluar ose ndryshuar vendimin e shkallës së parë, Gjykata Supreme e Kosovës e anulon ose e ndryshon edhe vendimin e Gjykatës së Apelit, edhe pse me të nuk është shkelur ligji.”

Neni 440 **[Mbrojtja e të drejtave sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut]**

“Mjetet e jashtëzakonshme juridike sipas këtij Kapitulli mund të paraqiten në bazë të të drejtave të siguruara me këtë Kod dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ose Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollat e saj, si dhe me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale i shfuqizuar me Kodin nr.08/L-032 të Procedurës Penale

Neni 432 **Arsyet për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë**

“1. Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet vijuese:

1.1. në rast të shkeljes së ligjit penal;

1.2. në rast të shkeljes esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1. i këtij Kodi; ose

1.3. në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, as kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni, Kryeprokurori i Shtetit mund të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për cilëndo shkelje ligjore.

4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet, gjatë procedurës penale e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit.”

Neni 441

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

“Kërkesë për mjet të jashtëzakonshëm juridik sipas këtij kapitulli mund të paraqitet në bazë të të drejtave të siguruara me këtë Kod dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ose Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet e saj, si dhe me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

Kodi UNMIK/RREG/2003/26 i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës i shfuqizuar me Kodin nr. 04/L-123 i Procedurës Penale

Neni 451

Pa titull

“(1) Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjës së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet vijuese:

1) Në rast të shkeljes së ligjit penal;

2) Në rast të shkeljes esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 403, paragrafi 1 i këtij Kodi ose

3) Në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

(2) Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, as kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

(3) Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, prokurori publik i Kosovës mund të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për cilëndo shkelje ligjore.

(4) Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet, gjatë procedurës penale e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit.”

Neni 460 Pa titull

“Kërkesë për mjet të jashtëzakonshëm juridik sipas këtij kapitulli mund të paraqitet në bazë të vendimit të Gjykatës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut në pajtim me procedurat që do të rregullohen me ligj”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

88. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse kërkesat i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
89. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 8 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

8. Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.

90. Gjykata i referohet neneve 51, 52 dhe 53 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 51 (Saktësimi i kërkesës)

“1. Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës do të parashtrohet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet zbatohet drejtpërdrejt në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.

2. Kërkesa do të specifikoj cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.”

Neni 52 (Procedura para Gjykatës)

“Pas ngritjes së kërkesës në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, procedura para gjykatës referuese do të suspendohet deri në nxjerrjen e një vendimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese.”

Neni 53 (Vendimi)

“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për pajtueshmërinë e dispozitës ligjore me Kushtetutën dhe nuk vendos për çështje të tjera faktike ose juridike që kanë të bëjnë me kontestin para gjykatës referuese.”

91. Gjykata, po ashtu, merr parasysih rregullin 75 të Rregullores së punës, që specifikon:

Rregulli 75 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 8 të nenin 113 të Kushtetutës dhe me nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit)

“(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me paragrafin (8) të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 51 (Saktësimi i kërkesës), 52 (Procedura para gjykatës) dhe 53 (Vendimi) të Ligjit.

(2) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli ka efekt suspenziv.

(3) Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë kërkesë sipas këtij rregulli, me kusht që:

(a) ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërdrejtë nga një gjykatë në lidhje me çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim; dhe

(b) ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës përkatëse.

(4) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të specifikojë se cilat dispozita të ligjit të kontestuar konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën. Lënda që është duke u shqyrtuar nga gjykata referuese i bashkëngjitet kërkesës.

(5) Gjykata referuese mund të parashtrojë kërkesë ex officio ose me kërkesën e njëres prej palëve në procedurë.

(6) Pas parashtrimt të kërkesës, Gjykata njofton gjykatën referuese në pajtim me paragrafin (8) të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenet 51 (Saktësimi i kërkesës) dhe 52 (Procedura para gjykatës) të Ligjit për efektin suspenziv të kërkesës, përkatësisht që të pezullojë procedurën lidhur me rastin në fjalë derisa Gjykata të marrë vendim.”

92. Në dritën e kornizës së mësipërme normative, rezulton se çdo kërkesë e dorëzuar sipas paragrafit 8 të nenit 113 të Kushtetutës, që të jetë e pranueshme, duhet t'i plotësojë kriteret në vijim:

a) Kërkesa të jetë dorëzuar nga një “gjykatë”;

b) Gjykata (referuese) duhet të mos jetë e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën;

c) Gjykata referuese duhet të specifikojë se cilat dispozitat të ligjit të kontestuar konsiderohen të papajtueshme me Kushtetutën;

d) Ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërdrejt nga gjykata referuese në rastin në shqyrtim para saj; dhe

e) Ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për të marrë vendim në rastin në shqyrtim.

93. Gjykata sjellë në vëmendje praktikën e saj gjyqësore e cila konfirmon kriteret e lartpërmendura, përkitazi me pranueshmërinë e kërkesave të paraqitura në bazë të nenit 113.8 të Kushtetutës (shih *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese, [KO157/18](#), parashtrues *Gjykata Supreme e Kosovës*, Aktgjykim i 28 marsit 2019, paragrafi 45; [KO126/16](#), parashtrues, *Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 marsit 2017, paragrafi 62; [KO142/16](#), parashtrues, *Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit*, Aktgjykim i 9 majit 2017, paragrafi 58).

94. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson nëse Gjykata referuese është palë e autorizuar për të parashtruar një kërkesë të tillë. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se kërkesat janë dorëzuar nga Gjykata Supreme dhe janë nënshkruar nga Kryetari i saj, në kuadër të autorizimeve që lidhen me funksionin e tij. Kërkesat theksojnë qartë se ato paraqiten nga Gjykata Supreme e cila duhet të vendosë për kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitura para saj nga palët e autorizuara. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesat e tanishme janë dorëzuar nga një “gjykatë” në kuptim të nenit 113.8 të Kushtetutës (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese, [KO157/18](#), parashtrues, *Gjykata Supreme e Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 48; [KO126/16](#), parashtrues, *Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit*, cituar më lart, paragrafët 55-60).
95. Gjykata po ashtu vëren se Gjykata referuese ka ngritur dyshime për sa i përket kushtetutshmërisë së dispozitave përkatëse të KPPRK-së . Për më tepër, Gjykata referuese ka specifikuar në mënyrë të veçantë paragrafin 2 të nenit 4, paragrafin 4 të nenit 432,dhe paragrafin 2 të nenit 438 të KPPRK-së , si dispozita të cilat i konsideron se mund të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.
96. Në vijim, Gjykata gjithashtu vlerëson nëse dispozitat e kontestuara të KPPRK-së duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti nga Gjykata referuese në lëndët në shqyrtim e sipër para saj dhe nëse kushtetutshmëria e dispozitave të kontestuara të KPPRK-së është parakusht për marrjen e vendimeve nga Gjykata referuese.
97. Gjykata konsideron se “zbatimi i drejtpërdrejtë” i normës konkrete nënkupton se nga zbatimi apo moszbatimi i drejtpërdrejtë i saj varet rezultati i vendimit nga Gjykata referuese. Përkatësisht, si pasojë e zbatimit apo moszbatimit të drejtpërdrejtë të normës konkrete, gjykatat e rregullta do të mund të merrnin vendime me rezultate të ndryshme (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, [KO157/18](#), cituar më lart, paragrafi 52).
98. Së këndejmi, në mënyrë që të ekzistojë lidhje e drejtpërdrejtë, duhet të ketë një raport të domosdoshëm ndërmjet vendimit të Gjykatës Kushtetuese (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga kjo Gjykatë) dhe zgjidhjes së çështjes kryesore nga Gjykata referuese, në kuptimin që gjykimi nga Gjykata referuese nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese (shih *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese, [KO157/18](#), cituar më lart, paragrafi 53; dhe [KO142/16](#), cituar më lart, paragrafi 62).
99. Në dritën e fakteve të rastit dhe shqyrtimeve të mësipërme, Gjykata konsideron se kërkesat ngrenë dyshime serioze që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e paragrafit 2 të nenit 4 (*Ne Bis In Idem*), paragrafit 4 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) dhe paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të KPPRK-së . Gjithashtu, Gjykata referuese ka argumentuar se nenet e kontestuara të KPPRK-së duhet të zbatohen drejtpërdrejtë në lëndët para saj.
100. Rrjedhimisht, për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, Gjykata konstaton se Gjykata referuese: (i) është palë e autorizuar; (ii) ngre dyshime të arsyeshme për Ligjin e kontestuar; dhe (iii) ka dëshmuar se ai ligj duhet të zbatohet drejtpërdrejt nga Gjykata referuese në rastet nën shqyrtim para saj. Po ashtu, Gjykata referuese ka arsyetuar se vlerësimi i kushtetutshmërisë së dispozitave të kontestuara të KPPRK-së është parakusht për të marrë vendime në rastet nën shqyrtim para saj dhe ka qartësuar se cilat dispozitat të KPPRK-së konsiderohen të papajtueshme me dispozita konkrete të Kushtetutës.
101. Prandaj, Gjykata konstaton që kërkesat janë të pranueshme për shqyrtim në merita.

Meritat e kërkesës

Hyrje

102. Gjykata vëren se kërkesat e bashkuara KO114/23 dhe KO227/23 ndërlihen me procedurë të paraburgimit në kuptim të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ), me ç'rast çështja që është ngritur para Gjykatës Supreme ka të bëjë me atë nëse (i) kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet edhe kundër vendimeve të formës së prerë për ndërprerjen e paraburgimit, ashtu siç është përcaktuar me paragrafin 4 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) të KPPRK-së; si dhe (ii) nëse në rast se, Gjykata Supreme konstaton se vendimi i formës së prerë është “*qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*”, përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë mund të vendos edhe në dëm të të pandehurit, ashtu siç është mundësuar përmes paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të KPPRK-së .
103. Në anën tjetër, kërkesat e bashkuara KO192/23 dhe KO229/23, kanë të bëjnë me kundërshtim të provave dhe hedhje të aktakuzës, përkatësisht vendimin e formës së prerë në procedurë penale, lidhur me të cilat, Gjykata referuese kryesisht ngrit çështje që ndërlihen me parimin *ne bis in idem*, siç garantohet me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në lidhje me nenin 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) i Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, dhe atë nëse (i) kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet edhe kundër vendimeve të formës së prerë përkitazi me të pandehurin, ashtu siç është përcaktuar me paragrafin 4 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) të KPPRK-së, përkatësisht nëse Gjykata Supreme në rast se konstaton se vendimi i formës së prerë është “*qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*”, përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë mund të vendos edhe në dëm të të pandehurit, ashtu siç është mundësuar përmes paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të KPPRK-së .
104. Prandaj, Gjykata rikujton se Gjykata referuese gjatë shqyrtimit të rasteve konkrete ka ngritur dyshime për papajtueshmërinë e paragrafit 2 të nenit 4 (Ne Bis In Idem), paragrafit 4 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) dhe paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të KPPRK-së, me nenet 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 34 [E drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.
105. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se objekt vlerësimi kushtetues në këtë kërkesë është (i) paragrafi 2 i nenit 4 (Ne Bis In Idem) i KPPRK-së që përcakton se “*Me përjashtim të rasteve kur me këtë Kod është paraparë ndryshe, vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike*”; (ii) paragrafi 4 i nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) i KPPRK-së që përcakton se: “*Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet, gjatë procedurës e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit*”; dhe (iii) paragrafi 2 i nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) i KPPRK-së që përcakton se: “*Kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*”, përkatësisht nëse këto të fundit janë në kundërshtim me të drejtat e njeriut të garantuara me nenet 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] dhe 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në ndërlihen me nenin 5 (E

drejta për liri dhe siguri) dhe nenin 4 (2) (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së.

106. Gjykata po ashtu sqaron se në pajtim me nenin 53 (Vendimi) të Ligjit, kjo e fundit vendos vetëm për pajtueshmërinë e dispozitës ligjore me Kushtetutën dhe nuk vendos për çështje të tjera faktike ose juridike që kanë të bëjnë me rastet në shqyrtim para Gjykatës referuese. Thënë ndryshe, Gjykata vlerëson vetëm nëse dispozita ligjore e kontestuar nga gjykata referuese është në përputhshmëri me normën kushtetuese, dhe për pasojë i takon Gjykatës referuese të aplikojë konstatimin e Gjykatës Kushtetuese në rrethanat e rastit që ka në shqyrtim para saj.
107. Në vijim, Gjykata në vlerësimin e kushtetutshmërinë së dispozitave përkatëse të KPPRK-së, do t'i shqyrtojë pretendimet e gjykatës referuese sa i përket (i) çështjes së paraburgimit, përkatësisht nëse kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet edhe në rastet kur me vendim të formës së prerë është ndërprerë paraburgimi; dhe (ii) nëse kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur në dëm të të pandehurit, mund të ketë efekt në vendimin e formës së prerë ndaj të pandehurit, përfshirë në rastet e paraburgimit.
108. Për këtë qëllim, Gjykata fillimisht do të elaborojë (i) pretendimet e Gjykatës referuese dhe argumentet e palëve të dorëzuara në Gjykatë; (ii) parimet e përgjithshme të vendosura përmes praktikës gjyqësore të vet Gjykatës dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ); për të vazhduar me (iii) aplikimin e tyre përgjatë vlerësimit të saj në rastin konkret.

I. Vlerësimi kushtetutshmërisë së paragrafit 4 të nenit 432 të KPPRK-së ndërlidhur me procedurën e paraburgimit (rastet e bashkuara KO114/23 dhe KO227/23)

109. Si çështje paraprake në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të KPPRK-së në kontekst të paraburgimit, Gjykata vlerëson se neni 4 (Ne Bis In Idem) i KPPRK-së në lidhje me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës paraqesin të drejta dhe garanci që nuk ndërlidhen me rrethanat e aplikueshme në rastet KO114/23 dhe KO227/23, përkatësisht çështjen që ndërlidhen me procedurat e paraburgimit. Kjo, ndër të tjera, sepse është e qartë se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e parashtruar nga prokurori i shtetit kundër vendimit për ndërprerjen e paraburgimit, nuk i referohet hetimit, akuzës apo gjykimit ndaj të pandehurit, por vetëm vendimeve të formës së prerë që kanë të bëjnë me caktimin, vazhdimin dhe ndërprerjen e paraburgimit.
110. Gjithashtu, në kontekst të asaj nëse kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet në dëm të të pandehurit, dhe si e tillë mund të ketë efekt në vendimin e formës së prerë ndaj të pandehurit në rastet e paraburgimit, e përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 438 të KPPRK-së, Gjykata vlerëson se kjo çështje ka efekt jo vetëm përkitazi me paraburgimin por edhe në vendimet që ndërlidhen me aktakuzën dhe vendimin për përfundimin e procedurës penale. Thënë këtë, kjo çështje do të adresohet përmes vlerësimit të kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 438 të KPPRK-së, në kuptim të efekteve të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur në dëm të të pandehurit.
111. Në këtë kuptim, Gjykata do të vijojë me vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të KPPRK-së në kontekst të paraburgimit siç ndërlidhet me rastet e bashkuara KO114/23 dhe KO227/23, përkatësisht vlerësimit të asaj nëse paragrafi 4 i nenit 432 (Arsyet për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) të KPPRK-së është në pajtueshmëri me të drejtën për liri dhe siguri, siç garantohet me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së. Për këtë qëllim dhe në vijim, Gjykata do të paraqes, (i) pretendimet e Gjykatës referuese dhe argumentet e palëve të interesuara; (ii) parimet e përgjithshme të vendosura nga Gjykata dhe GJEDNJ

përkitazi me të drejtën për liri dhe siguri, për aq sa janë relevante në rrethanat e rastit konkret; për të vazhduar me (iii) vlerësimin e kushtetutshmërisë së paragrafit 4 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) të KPPRK-së.

(i) Pretendimet e Gjykatës referuese dhe argumentet e palëve

112. Gjykata rikujton se paragrafi 4 i nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) i KPPRK-së përcakton se: *“Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet, gjatë procedurës e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.”* Gjykata, në vijim rikujton se ligjet e procedurës penale pararendëse të KPPRK-së përkitazi me rastet e paraburgimit kanë lejuar përdorimin e mjetit të jashtëzakonshëm por vetëm lidhur me vendimet me të cilat caktohej apo vazhdohej paraburgimi por jo edhe kundër vendimeve me të cilat ndërpritej paraburgimi. Lidhur me këtë Gjykata i referohet paragrafit 4 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) të Kodit nr. 04/L-123 (i shfuqizuar nga KPPRK) dhe paragrafit 4 të nenit 451 (Pa titull) të Kodit të Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës UNMIK/RREG/2003/26 (i shfuqizuar me Kodin nr. 04/L-123 i Procedurës Penale) të cilat parashikojnë që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit.
113. Në kontekst të të lartcekurave, Gjykata vëren se Gjykata referuese dyshimet për kundër-kushtetutshmërinë e paragrafit 4 të nenit 432 të KPPRK-së i bazon në faktin se me këtë të fundit është përcaktuar mundësia e paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë edhe përkitazi me ndërprerjen e paraburgimit, *“duke pas parasysht se paraburgimi është masë e sigurisë së pranisë së të pandehurit në procedurën penale, kurse sipas dispozitave të kodit të procedurës penale e drejta për liri dhe siguri duhet të interpretohet në favor të qëndrimit në liri dhe kjo masë (si masë më e rëndë) duhet të reduktohet në kohën sa më të shkurtër të mundshme”*. Në vijim, T.Rr, në cilësinë e mbrojtësit të palës në rastin KO114/23, po ashtu ngrit çështjen e kushtetutshmërisë së kësaj dispozite në kuptim praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

(ii) Parimet e përgjithshme të vendosura nga Gjykata dhe GJEDNJ përkitazi me të drejtën për liri dhe siguri

114. Fillimisht, Gjykata rithekson se bazuar në dispozitat e kontestuara të KPPRK-së, është lejuar mjeti juridik para Gjykatës Supreme, përkatësisht ai i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, kundër vendimeve për ndërprerjen e paraburgimit, për dallim nga kodet paraprake lidhur me procedurën penale dhe në të cilat, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë ishte lejuar vetëm kundër vendimeve për caktimin dhe vazhdimin e paraburgimit.
115. Në lidhje me këtë, Gjykata fillimisht thekson që, për të qenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ, arrestimi ose heqja e lirisë duhet të bazohet në një nga arsyet për heqjen e lirisë të parapara në nenin 29, paragrafin 1 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së.
116. Lidhur me këtë, Gjykata fillimisht rikujton nenin 29, paragrafin 1, pikën 2 të Kushtetutës që përcaktojnë:
1. *Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:*

[...]

(2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;

[...].”

117. Së dyti, Gjykata po ashtu i referohet nenit 5. 1 (c) të KEDNJ-së i cili përcakton që:

1.Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

[...]

c. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një veprë penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

118. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 29 të Kushtetutës, i cili përcakton që “Çdokush që i hiqet liria më arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit”.
119. Në vijim, Gjykata vëren se paragrafi 4 i nenit 5 të KEDNJ-së përcakton që: “Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.”
120. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata vëren, se në bazë të nenit 29, paragrafit 1, pikës 2 të Kushtetutës dhe nenit 5.1 (c) të KEDNJ-së, privimi i lirisë mund të bëhet në rast të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale, dhe kur një gjë e tillë konsiderohet e domosdoshme për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale ose largimin pas kryerjes së saj (shih rastet e Gjykatës, [KI10/18](#), me parashtrues *Fahri Deqani*, Aktgjykim, i 8 tetorit 2019, paragrafi 65 dhe [KI85/22](#), me parashtrues *Jadran Kostić*, Aktgjykim, i 26 prillit 2023, paragrafi 68). Prandaj, Gjykata thekson që për të qenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, caktimi i paraburgimit, duhet të ketë mbështetje në njërin nga bazat për privimin e lirisë të përcaktuara me nenin 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5, paragrafin 1 (c) të Konventës (shih rastin e Gjykatës, [KI85/22](#), i cituar më lart paragrafi 69).
121. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, qëllimi i nenit 5 të KEDNJ-ë është që të parandaloj privimin nga liria në mënyrë arbitrare apo të pajustificuar (shih rastin e GJEDNJ-së, [McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 543/03, Aktgjykim i 3 tetorit 2006, paragrafi 30).
122. GJENDJ, në praktiken e saj gjyqësore, së cilës i është referuar edhe vet Gjykata, ka përcaktuar tri (3) kritere themelore, që duhet ekzaminuar për të vlerësuar nëse privimi i lirisë është i ligjshëm dhe jo arbitrar (shih rastin e GJEDNJ-së, [Merabishvili kundër Gjeorgjisë](#) nr. 72508/13, Aktgjykim i 28 nëntorit 2017, paragrafi 183, dhe po ashtu shih rastet e Gjykatës, [KI10/18](#), të cituar më lart, paragrafi 67 dhe [KI85/22](#), me parashtrues *Jadran Kostić*, i cituar më lart, paragrafi 70).

- a. së pari, duhet të ekzistoj “*dyshimi i bazuar*” që një person i privuar nga liria ka kryer një vepër penale (shih rastin e GJEDNJ-së, *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, nr. 72508/13, Aktgjykim i 28 nëntorit 2017, paragrafi 184);
 - b. së dyti, qëllimi i privimit të lirisë “*është që në parim duhet të jetë në funksion të zbatimit të procedurës penale*” (shih rastin e Gjykatës [KI63/17](#), me parashtrues *Lutfi Dervishi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 16 nëntorit 2017, paragrafi 57; KI10/18, parashtrues *Fahri Deqani*, të cituar më lart, paragrafi 68; dhe KI85/22, me parashtrues *Jadran Kostić*, cituar më lart, paragrafi 70; shih po ashtu rastin e GJEDNJ-së, [Ostendorf kundër Gjermanisë](#), nr. 15598/08, Aktgjykim, i 7 marsit 2013, paragrafi 68), dhe që për më tepër, duhet të jetë proporcional, në kuptimin që duhet të jetë i nevojshëm “*për të siguruar paraqitjen e personit të afektuar para autoriteteve kompetente përkatëse*” (shih rastin e Gjykatës [KI63/17](#), parashtrues *Lutfi Dervishi*, i cituar më lart, paragrafi 57, shih po ashtu rastin e sipërcituar të GJEDNJ-së *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, paragrafi 185); dhe
 - c. së treti, privimi i lirisë apo caktimi i paraburgimit duhet të jetë bërë duke ndjekur procedurën e përcaktuar me ligj (shih rastin KI10/18, parashtrues *Fahri Deqani*, cituar më lart, paragrafi 68 dhe rastin e GJEDNJ-së *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, cituar më lart, paragrafi 186).
123. Për më tepër, GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore së cilës i është referuar edhe Gjykata, ka theksuar se neni 5, paragrafi 4 i KEDNJ-së përcakton që çdo person i arrestuar ose i ndaluar ka të drejtën për të kërkuar nga gjykata që të shqyrtojë kërkesat procedurale dhe ato përmbajtësore e që janë thelbësore për “*ligjshmërinë*” e heqjes së lirisë ndaj tij, në kuptimin e nenit 5, paragrafit 1 të KEDNJ-së (shih ndër të tjera rastet e GJEDNJ-së, [Idalov kundër Rusisë](#), nr. 5826/03, Aktgjykim, i 22 majit 2022, paragrafi 161; [Reinprecht kundër Austrisë](#), kërkesa nr. 67175/01, Aktgjykim, i 15 nëntorit 2005, paragrafi 31; dhe rastin e Gjykatës KI85/22, me parashtrues *Jadran Kostić*, cituar më lart, paragrafi 77).
124. Nocioni i “*ligjshmërisë*” në kuptimin e nenit 5, paragrafit 4 të KEDNJ-së ka të njëjtin kuptim si ai i nenit 5, paragrafit 1, aq sa çdo person i arrestuar ose i ndaluar ka të drejtën për të kërkuar që të shqyrtohet ligjshmëria e arrestimit të tij, jo vetëm në dritën e kërkesave të së drejtës së brendshme, por edhe në atë të KEDNJ-së, të parimeve themelore që përcaktohen aty dhe të qëllimit të kufizimeve të lejuara nga neni 5 paragrafit 1 i KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së, [Suso Musa kundër Maltës](#), nr. 42337/12, Aktgjykim, i 23 korrikut 2013, paragrafit 50; dhe rastin e Gjykatës, KI85/22, me parashtrues *Jadran Kostić*, cituar më lart, paragrafi 78).
125. Në mënyrë që parimi i “*ligjshmërisë*” të respektohet, paraburgimi duhet të jetë në pajtueshmëri me “*procedurën e përcaktuar ligjore*” (shih rastin e GJEDNJ-së, [Del Rio Prada kundër Spanjës](#), nr.42750/09, Aktgjykim i 21 tetorit 2013, paragrafi 125). Rrjedhimisht, për të përmbushur kërkesat respektive të Kushtetutës në lidhje me ato të KEDNJ-së, shqyrtimi nga ana e gjykatës duhet të jetë në pajtueshmëri si me rregullat përmbajtësore edhe me ato procedurale të legjislacionit dhe të zhvillohet në pajtim me qëllimin e nenit 29 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, përkatësisht mbrojtjen e individit nga arbitrariteti (shih në këtë kuptim rastin e GJEDNJ-së [Koendjibharie kundër Holandës](#), nr. 11487/85, Aktgjykim, i 25 tetorit 1990, paragrafi 27; dhe rastin e Gjykatës KI85/22, me parashtrues *Jadran Kostić*, cituar më lart, paragrafi 79).
126. Megjithatë, Gjykata rikujton se kërkesa për drejtësi procedurale që rrjedh nga paragrafi 4 i nenit 5 të KEDNJ-së nuk vendos obligimin që të zbatohen kriteret uniforme e të pandryshueshme, të pavarura nga konteksti, nga faktet dhe nga rrethanat. Ndonëse procedura që ndërlihet me paragrafin 4 të nenin 5 të KEDNJ-së nuk duhet të shoqërohet gjithmonë me garanci të njëjta si ato që kërkohen nga neni 6 i KEDNJ-së për procedurat civile ose penale, ajo duhet të ketë një karakter gjyqësor dhe t’i ofrojë individit të interesuar garanci të përshtatura sipas natyrës së heqjes së lirisë për të cilën ai ankohet (shih rastet e

GJEDNJ-së, [A. me të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 3455/05, Aktgjykim i 19 shkurtit 2009, paragrafi 203; dhe [Idalov kundër Rusisë](#), nr. 5826/03, Aktgjykim i 22 majit 2012, paragrafi 161).

127. Sipas GJEDNJ-së, për çdo person ndalimi i të cilit hyn në fushëveprimin e zbatimit të nenit 5 (1) (c) të KEDNJ-së kërkohet patjetër një seancë dëgjimore (shih rastin e GJEDNJ-së [Nikolova kundër Bullgarisë](#), nr. 31195/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999, paragrafi 58). Mundësia e një personi të privuar nga liria për t'u dëgjuar vetë personalisht ose përmes përfaqësuesit është një nga garancitë themelore procedurale në çështjet që ndërlidhen me heqjen e lirisë (shih rastin e GJEDNJ-së, [Kampanis kundër Greqisë](#), nr.17977/91, Aktgjykim i 13 korrikut 1995, paragrafi 47). Megjithatë, paragrafi 4 i nenit 5 të KEDNJ nuk kërkon që një i ndaluar të dëgjohet sa herë që ai paraqet ankesë kundër vendimit përmes të cilit vazhdohet heqja e tij e lirisë, por ai duhet të ketë mundësinë që të drejtën e tij/saj për t'u dëgjuar ta ushtrojë në intervale të arsyeshme (shih rastin e GJEDNJ-së, [Çatal kundër Turqisë](#), nr.26808/08, Aktgjykim i 17 prillit 2012, paragrafi 33).
128. Gjithashtu, sipas GJEDNJ-së, procedura duhet respektojë parimin e “kontradiktoritetit” dhe në të gjitha rastet të sigurojë “barazinë e armëve” ndërmjet palëve (shih rastin e GJEDNJ-së [Reinprecht kundër Austrisë](#), nr.67175/01, Aktgjykim i 15 nëntorit 2005, paragrafi 31). Parimet e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve duhet të respektohen në mënyrë të barabartë në procedurën para një gjykate të apelit. Megjithatë, GJEDNJ ka theksuar se parimi i kontradiktoritetit dhe ai i barazisë së palëve në rastet para saj, nuk ishte cenuar ose sepse asnjë nga palët nuk ka marrë pjesë në procedurat në nivel apeli ose sepse prezenca e përfaqësuesit të paraburgosurit ka qenë e mjaftueshme për të përmbushur këtë kërkesë (shih rastin e GJEDNJ-së, [Çatal kundër Turqisë](#), cituar më lart, paragrafi 34 dhe rastet e cituara aty).
129. Gjithashtu, sipas GJEDNJ-së, e drejta për liri dhe siguri përfshin edhe të drejtën për një vendim të shpejtë sa i përket ligjshmërisë së paraburgimit si dhe urdhrin për ndërprerje të të njëjtit nëse rezulton që paraburgimi ishte i paligjshëm (shih në këtë kuptim rastin e GJEDNJ-së, [Idalov kundër Rusisë](#), cituar më lart, paragrafi 154). Megjithatë sipas GJEDNJ-së, standardi i “shpejtësisë” është më pak i rreptë, kur kemi të bëjmë me procedura ankimore dhe se kur vendimi fillestar për paraburgim është dhënë nga gjykata në një procedurë që ofron garancitë e nevojshme të një procesi të rregullt, dhe në këto rrethana GJEDNJ është e gatshme të tolerojë një periudhë më të gjatë të vlerësimit në procedurën para gjykatës së instancës së dytë (shih rastin e GJEDNJ-së [Shcherbina kundër Rusisë](#), nr.41970/11, Aktgjykim i 26 qershorit 2014, paragrafi 65.)

(iii) Zbatimi i këtyre parimeve në rastin konkret

130. Gjykata vëren se bazuar në parimet e lartcekura, dhe për aq sa ato janë relevante për të vlerësuar kushtetutshmërinë e paragrafit 4 të nenit 432 të KPPRK-së përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë sa i përket ndërprerjes së paraburgimit, duhet pasur parasysh që neni 29 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së përcaktojnë, ndër të tjera, (i) bazat mbi të cilat një person mund të privohet nga liria bazuar në ligj dhe vendime të gjykatës; (ii) të drejtat që gëzon një person që privohet nga liria, përfshirë të drejtën që të informohet për arsyet e privimit nga liria dhe të drejtën që ai të dërgohet para gjyqtarit brenda një afati të caktuar; si dhe (iii) të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit apo ndalimit të tij/saj. Gjithashtu, bazuar në parimet e lartcekura, (iv) mjete juridik në fjalë duhet të jetë efektiv; dhe se gjatë procedurës duhet të garantohet (v) parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit; (vi) e drejta që rasti të vendoset në një periudhë sa më të shkurtër; dhe (iv) ndalimin e arbitraritetit në vendimmarrje. Përtej këtyre parimeve, neni 29 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ, vendosin theksin në parimin e “ligjshmërisë” përkatësisht që paraburgimi duhet të jetë në pajtueshmëri me

“procedurën e përcaktuar ligjore”, duke detyruar rregullimin e çështjeve procedurale në nivel ligji.

131. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se dispozitat e lartcekura të nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 5 të KEDNJ-së, përfshirë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përveç kushtit që të parashihet mjet ankese për të sfiduar ligjshmërinë e privimit nga liria, në parim, nuk përcaktojnë në mënyrë të detajuar natyrën e mjeteve juridike dhe as në sa instanca duhet shqyrtuar ligjshmëria e paraburgimit apo ndërprerja e paraburgimit. Nga kjo rezulton që përderisa garancitë e lartcekura nga neni 5 i KEDNJ-së janë respektuar, rregullimi i mëtejshëm i tyre përcaktohet përmes ligjit të brendshëm të secilit shtet, dhe të cilat rregullta shtetet duhet ti respektojnë.
132. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se neni 171 (Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit) të KPPRK-së ka përcaktuar paraburgimin si masë për të siguruar praninë e të pandehurit në procedurë. Gjykata po ashtu vëren se sipas nenit të lartcekur, përveç paraburgimit, janë përcaktuar edhe masa tjera për zbatim të suksesshëm të procedurës penale, përkatësisht masa të tjera më të buta, siç janë: (i) thirrja; (ii) urdhërarresti; (iii) premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin; (iv) ndalimi për t’iu afruar vendit ose personit të caktuar; (v) paraqitja në stacionin policor; (vi) dorëzania; dhe (vii) arresti shtëpiak.
133. Lidhur me këtë, Gjykata rithekson se KPPRK ka përcaktuar procedurën sipas së cilës caktohet dhe vazhdohet paraburgimi, duke përcaktuar edhe të drejtën e ankesës ndaj vendimeve për paraburgim, si për të pandehurin ashtu edhe për prokurorin e shtetit. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se për dallim nga kodet e mëhershme, KPPRK i kontestuar në paragrafin 4 të nenit 432 ka përcaktuar edhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë që mund të parashirohet jo vetëm sa i përket caktimit dhe vazhdimit të paraburgimit, por edhe sa i përket ndërprerjes së paraburgimit.
134. Gjykata vëren se paragrafi 4 i nenit 432 të KPPRK-së, nuk i përcakton efektet e vendimit të Gjykatës Supreme në raport me vendimin e formës së prerë përkitazi me paraburgimin, por vetëm mundësinë që një mjet i tillë juridik të mund të përdoret, pra si kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Prandaj, efektet e vendimmarrjes së Gjykatës Supreme në dëm të të pandehurit janë të rregulluara në paragrafin 2 të nenit 438 të KPPRK-së, që do të shqyrtohen ndaras përmes këtij Aktgjykimi.
135. Gjykata po ashtu vëren, se bazuar në nenin 433 (Personat e autorizuar për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë) të KPPRK-së, është përcaktuar se kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqesë Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij.
136. Në këtë aspekt, dispozita e kontestuar e KPPRK-së përcakton të drejtën që ndaj vendimit të formës së prerë të kërkohet vlerësimi i ligjshmërisë si në rastin e caktimit, vazhdimit të paraburgimit, ashtu edhe në rastin e ndërprerjes së paraburgimit. Ky mjet juridik mund të përdoret nga ana e prokurorisë, siç mund të përdoret mjete juridik ndaj vendimit për caktimin apo vazhdimin e paraburgimit nga ana e të pandehurit. Për më tepër, kjo dispozitë nuk përcakton ndonjë kufizim për të pandehurin, a ndonjë të drejtë që do të kishte në dispozicion pala tjetër sa i përket kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë por jo edhe i pandehuri. Andaj, të gjitha të drejtat në procedurë që janë në dispozicion për prokurorinë, janë po ashtu në dispozicion edhe për të pandehurin, dhe si të tilla respektojnë, në parim, parimin e *“kontradiktoritetit”* dhe atë të *“barazisë së armëve”*, të cekur më lart. Kjo po ashtu në harmoni me nenin 29 të Kushtetutës dhe nenin 5 i KEDNJ dhe detyrimit të rregullimit e çështjeve procedurale në nivel ligji.
137. Gjithashtu, në kontekst krahasues, Gjykata vëren se nga përgjigjet e pranuar nga gjykatat e shteteve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias rezulton se, varësisht nga

rregullimi ligjor i shtetit, nuk ka një praktikë të unifikuar sa i përket të drejtës së prokurorit për të përdorur mjete juridike siç është kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, përfshirë edhe në procedurë të paraburgimit. Përkatesisht, në legjislacionet përkatëse të disa nga shtetet e sipërpërmendura: (i) prokurori nuk ka në dispozicion mjet të jashtëzakonshëm për t'i kontestuar vendimet përfundimtare të gjykatave të rregullta, siç janë Suedia, Republika Çeke dhe Lihtenshtajni, përderisa në disa nga shtetet, (ii) prokurorit i mundësohet që të përdorë mjete të jashtëzakonshme juridike, përfshirë në kontekst të paraburgimit, megjithatë këto të fundit dallojnë sa i përket efekteve të vendimeve kur të njëjtat janë në dëm të të pandehurit, me ç'rast shumica nga to, përcaktojnë që ky mjet juridik nuk mund të ketë efekt në dëm të të pandehurit.

138. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se përcaktimi përmes paragrafit 2 të nenit 432 të KPPRK-së, që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet edhe sa i përket “*ndërprerjes së paraburgimit*”, nuk është në vetvete në kundërshtim me nenin 29 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 5 të KEDNJ-së.
139. Ndërsa, sa i përket çështjes së ngritur nga Gjykata Supreme se dispozitat e paraburgimit duhet të interpretohen në favor të qëndrimit në liri dhe se kjo masë duhet të reduktohet në kohë sa më të shkurtër të mundshme, Gjykata vëren se në rastet kur paraqitet kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të ndërprerjes së paraburgimit, i pandehuri vetëm se është liruar nga paraburgimi, andaj, i takon Gjykatës Supreme që ngjashëm sikurse në rastet kur paraqitet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të caktimit ose vazhdimit të paraburgimit, të vendos edhe për ligjshmërinë e ndërprerjes së paraburgimit, nëse një kërkesë e tillë paraqitet.
140. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se efektet e vendimmarrjes së Gjykatës Supreme, sa i përket kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, përfshirë vendimmarrjes në dëm të të pandehurit, nuk janë të përcaktuara me nenin 432 të KPPRK-së, por me nenin 438 të tij, kushtetutshmëria e së cilit do të vlerësohet në vijim të këtij Aktgjykimi.
141. Në dritën e të lartcekurave, Gjykata konstaton se formulimi “*ose ndërprerjen*” i paragrafit 4 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, nuk është në kundërshtim me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së.

II. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 4 (Ne Bis In Idem), dhe paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë)

142. Në vijim, Gjykata do të paraqes, (i) pretendimet e Gjykatës referuese dhe argumentet e palëve të interesuara; (ii) parimet e përgjithshme të vendosura nga Gjykata dhe GJEDNJ përkitazi me të drejtën për liri dhe siguri, për aq sa janë relevante në rrethanat e rastit konkret; për të vazhduar me (iii) vlerësimin e kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 4 (Ne Bis In Idem), dhe paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë).

(i) Pretendimet e Gjykatës referuese dhe argumentet e palëve

143. Gjykata vëren se në kontekst të kërkesave të paraqitura para Gjykatës, Gjykata referuese specifikon se rastet që ndërlidhen me vendimet e formës së prerë sa i përket paraburgimit, kundërshtimit të provave dhe hedhjes së aktakuzës, dhe vendimit të formës së prerë në procedurë penale, ngrenë çështje të parimit *ne bis in idem*, të garantuara me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 2 të nenit 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) i Protokollit nr.

7 të KEDNJ-së. Kjo për faktin se sipas gjykatës referuese, Gjykata Supreme bazuar në paragrafin 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të KPPRK-së mund të konstatojë se vendimi i formës së prerë është “*qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*” dhe në këtë rast kjo vendimmarrje mund të kishte efekt në vendimin e formës së prerë edhe në dëm të të pandehurit. Në këtë kuptim, Gjykata referuese konteston paragrafin 2 të nenit 4 të KPPRK-së që përcakton se “*Me përjashtim të rasteve kur me këtë Kod është paraparë ndryshe, vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike*”; dhe paragrafin 2 të nenit 438 të KPPRK-së “*Kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë.*”

144. Në lidhje me këto dy dispozita të kontestuara nga ana e gjykatës referuese, kjo e fundit pretendon se sipas kodeve të mëhershme të procedurës penale kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur në dëm të të pandehurve kishte vetëm efekt deklarativ, përkatësisht Gjykata Supreme mund të konstatonte vetëm shkelje të ligjit por pa ndikuar në vendimin e formës së prerë. Përderisa në lidhje me paragrafin 2 të nenit 438 të KPPRK-së, sipas tyre (i) nuk është e qartë se çfarë nënkuptohet me termin e përdorur nga legjislacioni “*qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*”; (ii) si duhet të veprojë gjykata pasi ka konstatuar se bëhet fjalë për një “*vendim qartazi të papërshtatshëm ose të bazuar në gabim të rëndë*”; dhe (iii) nëse vendosja në dëm të të pandehurit, sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë së Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, me mjet të jashtëzakonshëm juridik, është në përputhje me parimet dhe dispozitat kushtetuese, si dhe me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Të njëjtat pretendime të gjykatës referuese mbështeten edhe nga Avokati i Popullit sipas të cilit është e papranueshme që veprimet procedurale të bazohen në një normë e cila nuk e përcakton qartë se kur një vendim i formës së prerë është “*i papërshtatshëm*”, apo kur është “*i bazuar në gabim të rëndë*”, pasi normat procedurale duhet të jenë të qarta dhe të parashikueshme.

(ii) parimet e përgjithshme të vendosura nga Gjykata dhe GJEDNJ përkitazi me të drejtën për të mos t’u gjykuar ose dënuar dy herë për të njëjtën vepër

145. Përkitazi me pretendimet e Gjykatës referuese për shkelje të të drejtës për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë për të njëjtën vepër, Gjykata i referohet dispozitave relevante të Kushtetutës dhe të nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së.
146. Gjykata rikujton se neni 34 i Kushtetutës përcakton se “*askush nuk mund të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale.*”
147. Gjykata gjithashtu i referohet edhe paragrafit 1 të nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së që përcaktojnë se: “*Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksioni i të njëjtit Shtet për një vepër për të cilën ai më parë ka qenë shpallur përfundimisht i pafajshëm ose dënuar në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij Shteti*”. [Sqarim i Gjykatës: për termin “*finally*” në versionin anglisht të përcaktuar në nenin 4 të Protokollit nr.7 të KEDNJ-së, në versionin shqip në Aktgjykim është përdorur termi “*përfundimisht*”, pasi ky term korrespondon me termin anglisht “*finally*”]
148. Gjykata gjithashtu i referohet edhe paragrafit 2 të nenit 4 të Protokollit nr.7 të KEDNJ-së që përcakton se: “*Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit të interesuar, në rast se fakte të reja ose të zbuluara rishtazi, ose një mangësi themelore në procedimet e mëparshme janë të një natyre të tillë që mund të cenojnë vendimin e dhënë.*”

149. Nga sa më sipër, rezulton se sipas nenit 4 të Protokollit nr.7 të KEDNJ-së (i) askush nuk mund të ndiqet ose dënohet dy herë për të njëjtën vepër penale për të cilën është dënuar ose liruar përfundimisht; përveç nëse rasti (ii) rihapet në përputhje me ligjin dhe procedurën penale në rast se ka fakte të reja ose të zbuluara rishtazi, ose ka pasur një mangësi themelore në procedimet e mëparshme.
150. Në vijim, Gjykata do të paraqes dhe do të elaborojë parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së përkitazi me nenin 4 të Protokollit nr.7 të KEDNJ-së, dhe kushteve që duhet të plotësohen në mënyrë që neni 4 i Protokollit nr.7 të KEDNJ-së të jetë i aplikueshëm, duke u fokusuar në elementet thelbësore që ndërlidhen me rrethanat e rastit konkret. Nëse rezulton se neni 4 i Protokollit nr.7 të KEDNJ-së, nuk është i aplikueshëm, atëherë në rastin konkret nuk mund të zbatohen garancitë e parmit *ne bis in idem*, të përcaktuara në nenin 4 të Protokollit nr.7 të KEDNJ-së.
151. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, garancia e parashikuar në nenin 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, zë një vend të spikatur në sistemin e mbrojtjes të KEDNJ-së, siç nënvizohet nga fakti se sipas nenit 15 të Konventës asnjë shmangie nga ajo nuk lejohet në rast lufte ose rreziku tjetër publik. Mbrojtja kundër përsëritjes së procedurave penale është një nga masat mbrojtëse specifike që ndërlidhen me garancinë e përgjithshme për një gjykim të drejtë në procedurë penale (shih rastin e GJEDNJ-së, [Mihalache kundër Rumanisë](#) nr. 54012/10, Aktgjykim i 8 korrikut 2019, paragrafët 47 dhe 48).
152. Sipas GJEDNJ-së, neni 4 i Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, thekson se parimi *ne bis in idem* ka për objekt të mbrojtë personat që tashmë janë “shpallur të pafajshëm ose dënuar përfundimisht”. Raporti Shpjegues i Protokollit nr.7, në lidhje me nenin 4 të KEDNJ-së, thekson se: “parimi i vendosur në këtë dispozitë zbatohet vetëm pasi që personi të jetë liruar ose dënuar përfundimisht në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit në fjalë”. Në mënyrë që një person të kualifikohet për mbrojtje sipas këtij neni, një vendim përfundimtar nuk është i mjaftueshëm, por vendimi përfundimtar duhet të përfshijë gjithashtu shpalljen e “pafajësisë apo dënimit” e personit. Prandaj, në secilin rast, GJEDNJ duhet të përcaktojë nëse kishte një shpallje pafajësie apo dënim (shih rastin [Mihalache kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 88).
153. Në vijim të kësaj, GJEDNJ ka nënvizuar se zgjedhja e qëllimshme e fjalëve “i shpallur i pafajshëm ose i dënuar” nënkuptonte që përgjegjësia “penale” e të akuzuarit ishte vendosur pas vlerësimit të rrethanave të çështjes, me fjalë të tjera se ka pasur një përcaktim për meritat e çështjes. Në mënyrë që të bëhet një vlerësim i tillë, është e rëndësishme jetike që autoriteti që nxjerrë vendimin të posedoj fuqinë vendimmarrëse që i jepet nga ligji i brendshëm që i mundëson atij të shqyrtojë meritat e një çështjeje. Autoriteti duhet të shqyrtojë ose vlerësojë provat në shkresat e çështjes dhe të vlerësojë përfshirjen e parashtruesit të kërkesës në një ose të gjitha ngjarjet që nxisin ndërhyrjen e organeve hetimore, për qëllimet e përcaktimit nëse është vërtetuar përgjegjësia “penale” (shih rastin [Mihalache kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 97).
154. Në këtë aspekt, GJEDNJ vendos theksin në vendimin “përfundimtar” për dënimin ose lirimin e të pandehurit. GJEDNJ ka sqaruar edhe metodologjinë e saj për vlerësimin që një vendim është “përfundimtar”. Ajo shpjegoi se, në përcaktimin e mjeteve juridike “të zakonshme” në një rast të veçantë për qëllimin e nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, ajo referohet në ligjin dhe procedurën e brendshme, si pikënisje, ku përcaktohen karakteristikat e një mjeti të tillë. Ligji i brendshëm, si përmbajtësor ashtu edhe procedural, duhet të përmbushë parimin e sigurisë juridike, i cili kërkon që qëllimi i një mjeti juridik për qëllimet e nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së (i) të kufizohet qartë në kohë; dhe (ii) që procedura për përdorimin e tij të jetë e qartë për ato palë që lejohen të përdorin mjetin juridik në fjalë. Me fjalë të tjera, që të përmbushet parimi i sigurisë juridike, sipas GJEDNJ-së, një parim që është i natyrshëm në të drejtën për të mos u

- grykuar ose dënuar dy herë për të njëjtën vepër, një mjet juridik duhet të funksionojë në një mënyrë që të sjellë qartësi deri në momentin kur një vendimi bëhet “përfundimtar”. Në veçanti, kërkesa e një afati kohor në mënyrë që një mjet juridik të konsiderohet si “i zakonshëm” është i nënkuptuar në formulimin e vetë raportit shpjegues, i cili thotë se një vendim është i përvokueshëm kur palët kanë lejuar “afatin kohor” të skadojë pa përfutuar nga një mjet i tillë. Në këtë kuptim, sipas GJEDNJ-së, një ligj që i jep diskrecion të pakufizuar njëres nga palët për të përdorur një mjet të veçantë juridik ose duke i nënshtruar një mjet të tillë kushteve që zbulojnë një çekuilibër të madh ndërmjet palëve në aftësinë e tyre për ta shfrytëzuar atë, do të binte ndesh me parimin e sigurisë juridike (shih rastin *Mihalache kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 115).
155. Prandaj, nga pikëpamja e nenit 4 të Protokollit nr.7 të KEDNJ-së, një mjet juridik i cili rezulton në vendim përfundimtar, ndaj të cilit të zbatohen garancitë e nenit 4 të Protokollit 7 të KEDNJ-së, nuk karakterizohet domosdoshmërisht nga emërtimi sipas ligjit të brendshëm të shtetit, si mjet i “zakonshëm”, por karakterizohet bazuar në karakteristikat e të njëjtit sipas kriterëve të lartcekura të vendosura edhe nga GJEDNJ.
156. Prandaj, GJEDNJ ka theksuar se neni 4 i Protokollit nr.7 të KEDNJ-së, ka për objekt që ta ndalojë përsëritjen e procedimeve penale (parimi *ne bis in idem*) të përfunduara me “vendim përfundimtar”. Sipas raportit shpjegues rreth Protokollit nr.7, raport që i referohet Konventës Evropiane për Vlefshmërisë Ndërkombëtare të Vendimeve Penale, “një vendim është përfundimtar” në qoftë se i njëjti, sipas shprehjes tradicionale, e ka marrë fuqinë e gjësë së grykuar –*res judicata*. I tillë është rasti kur ai është i përvokueshëm, domethënë kur kundër tij nuk ka më mundësi mjete të “zakonshme juridike” ose kur palët i kanë shteruar këto mjete apo i kanë lënë afatet të kalojnë pa i ushtruar ato (shih në këtë kuptim, rastet e GJEDNJ-së, *Sergey Zolotoukhin kundër Ruisë*, nr. 14939/03, Aktgrykim i 10 shkurtit 2009, paragrafi 107; dhe *Nikitin kundër Ruisë*, nr. 50178/99, Aktgrykim i 20 korrikut 2004, paragrafi 37).
157. Në vijim të kësaj, GJEDNJ ka specifikuar se, vendimet kundër të cilave ka mundësi për përdorimin e mjeteve të “zakonshme” juridike, nuk përfitojnë nga garancia që përmban neni 4 i Protokollit nr. 7, për aq kohë sa nuk ka përfunduar afati i ankimit. Në anën tjetër, sipas GJEDNJ-së mjetet e jashtëzakonshme juridike, si (i) kërkesa për rihapje të procedurës; apo (ii) ndonjë kërkesë për zgjatje të një afati të përfunduar, nuk merren fare parasysh kur është fjala për të përcaktuar nëse procedura ka përfunduar me vendim përfundimtar apo jo. Edhe pse këto mjete juridike përfaqësojnë një vazhdim të procedurës së parë, karakteri “përfundimtar” i vendimit nuk varet nga ushtrimi i tyre (shih rastin *Sergey Zolotoukhin kundër Ruisë*, cituar më lart, paragrafi 108).
158. Në rastin *Mihalache kundër Rumanisë*, parashtruesi i kërkesës në vitin 2008 ishte ndaluar nga policia duke drejtuar automjetin e tij dhe pasi i ishte bërë një test i alkoolit dhe kishte rezultuar pozitiv, ai kishte refuzuar marrjen e mostrave të gjakut për të vërtetuar nivelin e alkoolit në trup. Procedura penale e iniciuar ndaj tij ishte përfunduar pasi zyra e prokurorisë kishte vendosur që veprimet e tij nuk ishin aq serioze për të bërë akuzë penale. Andaj, i njëjti ishte detyruar vetëm që të paguaj një gjobë administrative. Ndaj këtij vendimi ishin shterur mundësitë për t’u ankuar. Në vitin 2009, zyra e lartë e prokurorisë kishte rihapur rastin e tij me arsyetimin se gjoba administrative nuk ishte e mjaftueshme nën dritën e rrezikut që kishte shkaktuar parashtruesi i kërkesës ndaj shoqërisë. Në këtë aspekt, GJEDNJ kishte gjetur se ai ishte grykuar dy herë për të njëjtën vepër dhe se si pasojë neni 4 i Protokollit nr.7 i KEDNJ-së ishte i aplikueshëm pasi rasti i ishte rihapur si pasojë e urdhrimit të prokurorisë së nivelit më të lartë për rihapje të rastit. Në këtë kontekst, në vlerësimin nëse në rastin konkret mjeti juridik i përdorur nga prokuroria ishte i “zakonshëm” GJEDNJ gjeti si ky nuk ishte rasti. Kjo pasi sipas GJEDNJ-së, një mundësi për të shqyrtuar dhe rihapur me (i) vetiniciativë të saj, në kontekstin e mbikëqyrjes hierarkike, meritat e vendimeve të marra nga një prokurori e një niveli më të ulët përkitazi

me të cilin ishin shterur mundësitë e ankesës, dhe për ta anuluar atë, (ii) pa u lidhur me ndonjë afat të caktuar nga ana e prokurorisë, nuk përbënte një “*mjet të zakonshëm juridik*” dhe si e tillë, ky mjet juridik nuk ndikoi në çështjen e plotfuqishmërisë së vendimit të marrë nga zyra e prokurorisë që kishte vendosur që veprimet e tij nuk ishin aq serioze për të bërë akuzë penale në vitin 2008, ndaj të cilin ishin shterur edhe mundësitë për ankesë.

159. Në rastin *Sundqvist kundër Finlandës*, GJEDNJ, në dritën e së drejtës së brendshme të zbatueshme kishte gjetur se vendimi i një prokurori për të mos nisur ndjekje nuk duhej të konsiderohej si një vendim “*përfundimtar*”. Për rrjedhojë, fakti që Prokurori i Përgjithshëm më vonë kishte paraqitur akuzën ndaj parashtruesit edhe pse një prokuror i shtetit kishte vendosur të mos ndiqte personin për vepër penale, nuk përbënte ndonjë procedim të ri që përfshihej në fushëveprimin e nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së. GJEDNJ kishte theksuar se heqja dorë nga ndjekja penale nga ana e një prokurori nuk është e barasvlershme as me një dënim, as me një shpallje pafajësie dhe se, për rrjedhojë, neni 4 i Protokollit nr. 7, nuk gjen zbatim në këtë situatë (shih rastin e GJEDNJ *Smirnova e Smirnova kundër Ruisë* nr. 75602/01, Vendim i 25 nëntorit 2005).
160. GJEDNJ gjithashtu ka theksuar se neni 4 i Protokollit nr.7 të KEDNJ-së, nuk është i zbatueshëm as në mbylljen e një procedimi penal të vendosur për arsye të amnistimit të akteve që përbëjnë shkelje të rënda të të drejtave themelore, si krime lufte kundër popullsisë civile. Në lidhje me këtë, GJEDNJ ka thënë se do të ishte në kundërshtim me detyrimet që i takojnë shtetit në bazë të neneve 2 dhe 3 të KEDNJ-së që të amnistohen veprat e vrasjes ose të keqtrajtimeve të kryera ndaj civilëve, dhe ajo ka vënë në dukje ekzistencën e një prirjeje në rritje në të drejtën ndërkombëtare për ta konsideruar si të papranueshëm amnistimin e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Për rrjedhojë, ajo erdhi në përfundimin se ngritja e një aktakuze të re ndaj një personi të amnistuar për akte të tilla nuk duhet të përfshihet në fushëveprimin e nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së, *Marguš kundër Kroacisë*, nr.4455/10, Aktgjykim i 27 majit 2014).

(iii) Zbatimi i këtyre parimeve në rastin konkret

161. Bazuar në parimet e lartcekura të vendosura nga GJEDNJ rezulton se:
- (i) askush nuk mund të ndiqet ose dënohet dy herë për të njëjtën vepër penale për të cilën është dënuar ose liruar “*përfundimisht*”; përveç nëse
 - (ii) rasti rihapet në përputhje me ligjin dhe procedurën penale kur ka fakte të reja ose të gjetura rishtazi, ose ka pasur një mangësi themelore në procedurat e mëparshme.
162. Në mënyrë që neni 34 i Kushtetutës dhe neni 4 i Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, të jenë të aplikueshme, dhe të pandehurit të gëzojnë mbrojtje nga neni i lartcekur, përveç kriterëve të tjera, duhet të vlerësohet nëse, kriteret e poshtëshënuara janë plotësuar dhe atë në mënyrë kumulative:
- (i) a kanë qenë të dy procedurat me natyrë “*penale*”; dhe nëse po,
 - (ii) a kishin të bëjnë të dy procedurat me të njëjtën vepër për të cilën një person është “*liruar apo dënuar*” me një “*vendim përfundimtar*”.
163. Në rastin konkret, bazuar edhe në pretendimet e Gjykatës referuese të cilët ngritin çështjen e vendosjes në dëm të të pandehurve përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, dhe atë në aspekt të qartësisë së termit “*vendim qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*” por edhe në kontekst të parimit *ne bis in idem*, fillimisht duhet të vlerësohet nëse kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, para Gjykatës Supreme konsiston në dyfishim të procedurës ndaj të pandehurve, përkatësisht nëse një vendim i Gjykatës së Apelit është

vendim “përfundimtar” në kuptimin e parimit *ne bis in idem*, i garantuar me nenin 34 të Kushtetutës dhe nenin 4 të Protokollit nr.7 të KEDNJ-së.

164. Bazuar në parimet e lartcekura, për të vlerësuar nëse një vendim është “përfundimtar” nga pikëpamja e nenit 4 të Protokollit nr.7 të KEDNJ-së, sa i përket “*lirimit apo dënimit për vepër penale*”, do të merren përsysh parimet e lartcekura të vendosura nga GJEDNJ-ja sipas të cilave rezulton se: (i) në mënyrë që garancitë e nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së të jenë të aplikueshme, një “*vendim përfundimtar*” nuk është i mjaftueshëm, por vendimi përfundimtar duhet të përfshijë gjithashtu shpalljen e “*pafajësisë apo dënimit e personit*”; (ii) autoriteti që nxjerrë vendimin, duhet të posedojë fuqinë vendimmarrëse që i jepet nga ligji i brendshëm që i mundëson atij të shqyrtojë meritat e një çështjeje; (iii) një vendim është “përfundimtar” në qoftë se i njëjti, sipas një ndërparimeve thelbësore të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ka marrë fuqinë e gjësë së gjykuar –*res judicata*, përkatësisht nëse vendimi është i parevokueshëm, që nënkupton se kundër atij vendimi nuk ka më mundësi parashtimi të mjeteve juridike, që plotësojnë kriteret e nenit 4 të Protokollit nr.7 të KEDNJ-së, ose kur palët i kanë shteruar këto mjete apo i kanë lënë të kalojnë afatet e përcaktuara me ligj pa i ushtruar ato; (iv) në vlerësimin nëse një mjet juridik është i “*zakonshëm*” apo i “*jashtëzakonshëm*” si pikënisje merret ligji dhe procedurat e brendshme, por vlerësimi bazohet në karakteristikat e mjetit juridik, dhe jo vetëm emërtimin e tij, përkatësisht që i njëjti duhet të në harmoni me parimin e sigurisë juridike, në kuptim të nenit 4 të Protokollit nr.7 të KEDNJ-së, përkatësisht që një mjet juridik për qëllimet e nenit 4 të Protokollit nr.7 të KEDNJ-së duhet të jetë (a) i përkufizuar qartë në kohë; dhe që (b) procedura për përdorimin e tij të jetë e qartë për ato palë që afektohen dhe që lejohen të përdorin mjetin juridik në fjalë; (v) vendimet kundër të cilave ka mundësi për përdorimin e mjeteve juridike sipas kriterëve të lartcekura, nuk përfitojnë nga garancia që përmban neni 4 i Protokollit nr.7 të KEDNJ-së, për aq kohë sa nuk ka përfunduar afati i ankimit; dhe (vi) një ligj që (a) i jep diskrecion të pakufizuar, përfshirë në aspekt kohor, njëri nga palët për të përdorur një mjet të veçantë juridik; ose (b) duke i nënshtuar një mjet të tillë kushteve që vënë më pah një çekuilibër të madh ndërmjet palëve në mundësitë e tyre për ta shfrytëzuar atë, do të binte ndesh me parimin e sigurisë juridike.
165. Prandaj, në vazhdim Gjykata do të vlerësojë kriteret e lartcekura në raport me paragrafin 2 të nenit 4 të KPPRK-së që përcakton se vendimi i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike dhe paragrafin 2 të nenit 438 të KPPRK-së që përcakton se përmes kërkesës për mbrojtje të lighsmërisë Gjykata Supreme, përjashtimisht mund të vendos edhe në dëm të të pandehurit nëse “*vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*”.
166. Gjykata në vijim i referohet edhe njëherë paragrafit 1 të nenit 4 (Ne Bis In Idem) të KPPRK-së, i cili përcakton se: “*Askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për vepër penale për të cilën është liruar ose për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, përkatësisht nëse procedura penale kundër tij është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës*”.
167. Megjithatë, paragrafi 2 i nenit 4 të përcakton se “*Me përjashtim të rasteve kur me këtë Kod është paraparë ndryshe, vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike*”.
168. Rrjedhimisht, rezulton se sipas nenit 4 të KPPRK-së, vendimi i formës së prerë mund të ndryshohet përmes mjeteve të jashtëzakonshme juridike. Kjo dispozitë nuk përcakton nëse (i) një vendim i tillë mund të ndryshohet në dobi apo edhe në dëm të të pandehurit; dhe as (ii) efektet tjera në raport me të. Për më tepër, kjo dispozitë i referohet të gjitha mjeteve të jashtëzakonshme juridike, prandaj përveç përkitazi me (i) kërkesën për mbrojtje të

- ligjshmërisë; vlen edhe përkitazi me (ii) kërkesën për rishikimin e procedurës; dhe (iii) kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit.
169. Megjithatë, mënyra e paraqitjes së mjeteve të jashtëzakonshme juridike, palët e autorizuar për t'i paraqitur ato, si dhe efektet në raport me të pandehurit, rregullohen me dispozita të tjera të KPPRK-së, përfshirë paragrafin 2 të nenit 438 të KPPRK-së. Si rrjedhojë e kësaj, në vazhdim, paragrafi 2 i nenit 4 të KPPRK-së do të vlerësohet në ndërlidhje me paragrafin 2 të nenit 438 të tij, në kuptimin e efekteve të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, përkatësisht atyre që mund të rezultojnë edhe në dëm të të pandehurit.
 170. Lidhur me këtë, Gjykata rithekson se nënkapitulli V [Mjetet e jashtëzakonshme juridike] i KPPRK-së përcakton mjetet e jashtëzakonshme juridike ku përfshihen (i) kërkesa për rishikimin e procedurës penale; (ii) kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë; dhe (iii) kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit.
 171. Sipas paragrafit 3 të nenit 419 (Mjetet e jashtëzakonshme juridike) të KPPRK-së *“Pala mund të paraqesë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre (3) muajsh nga dita kur është dorëzuar aktgjykimi i formës së prerë ose aktvendimi i formës së prerë kundër të cilit kërkohet mbrojtja e ligjshmërisë”*, gjë që rezulton se kërkesa është e limituar në kohë.
 172. Në vijim, Gjykata vëren se sipas paragrafit 1 të nenit 433 (Personat e autorizuar për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë) KPPRK-së *“Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqesë Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij.”* Ndërsa sipas paragrafit 2 të këtij neni: *“Zyra e Kryeprokurorit të shtetit, i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe personat e paraparë në nenin 424, paragrafin 1 të këtij Kodi mund të paraqesin kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre (3) muajve nga dita e dorëzimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë”*. Nga kjo rezulton se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e hapur si për të pandehurin ashtu edhe për prokurorinë.
 173. Bazuar në paragrafin 1 të nenit 432 të KPPRK-së, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet (i) në rast të shkeljes së ligjit penal; (ii) në rast të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1 i KPPRK-së; ose (iii) në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Bazuar në paragrafin 3 të nenit 432 të KPPRK-së, Kryeprokurori i Shtetit mund të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për cilëndo shkelje ligjore. Megjithatë, bazuar në paragrafin 2 të njëjtë nen: *“kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, as kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë”*.
 174. Gjithashtu, Gjykata vëren se sipas nenit 440 (Mbrojtja e të drejtave sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut) të KPPRK-së, mjetet e jashtëzakonshme juridike sipas këtij Kapitulli mund të paraqiten në bazë të të drejtave të siguruara me KPPRK dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ose Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet e saj, si dhe me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
 175. Për më tepër, bazuar në paragrafin 1 të nenit 438 të KPPRK-së kur Gjykata Supreme vërteton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, merr aktgjykim me të cilin, duke pasur parasysh llojin e shkeljes: (i) ndryshon vendimin e formës së prerë; (ii) në tërësi ose pjesërisht e anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë dhe e kthen rastin në rigjykim; ose (iii) kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit. Për më tepër, bazuar në paragrafin 2 të këtij neni, i cili edhe është kontestuar para Gjykatës,

- Gjykata Supreme vendos në dobi të të pandehurit, përveç nëse vendimi i formës së prerë është *“qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë”*, që nënkupton që në këtë rast mund të vendos edhe në dëm të të pandehurit.
176. Sa i përket efekteve të vendimit të formës së prerë, Gjykata i referohet nenit 485 (Forma e prerë dhe ekzekutueshmëria e vendimit) të KPPRK-së, përmes të cilit në paragrafin 1 përcakton se: *“Aktgjykimi merr formë të prerë kur më nuk mund të kundërshtohet me ankesë ose kur nuk lejohet ankesë.”* Ndërsa paragrafi 2 i nenit të 485 të KPPRK-së përcakton se *“Aktgjykimi i formës së prerë ekzekutohet kur është bërë dorëzimi dhe kur për ekzekutimin e tij nuk ka pengesa ligjore. Në qoftë se nuk është parashtruar ankesë ose palët kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë apo janë tërhequr nga ankesa e parashtruar, aktgjykimi konsiderohet i ekzekutueshëm pas kalimit të afatit për ankesë apo nga dita e heqjes dorë ose e tërheqjes së ankesës.”* Për më tepër, sipas paragrafit 4 të nenit 435 të KPPRK-së *“Varësisht nga përmbajtja e kërkesës, Gjykata Supreme e Kosovës mund të caktojë shtyrjen ose ndërprerjen e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë”*.
177. Rrjedhimisht, Kodi i Procedurës Penale përcakton dy çështje që ndërlidhet me efektet e një vendimi të formës së prerë, përkatësisht, (i) se një Aktgjykim bëhet i tillë nëse nuk kundërshtohet me ankesë ose nuk lejohet ankesa; dhe se në rast se një vendim bëhet i formës së prerë, i njëjti është (ii) i ekzekutueshëm; përveç (iii) kur pas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, vendoset që ekzekutimi i të njëjtit të shtyhet.
178. Prandaj, bazuar në të lartcekurat rezultojnë se:
- (i) kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet brenda tre (3) muajve nga dorëzimi i vendimit të formës së prerë, pra është e limituar në kohë dhe nuk është në diskrecion të prokurorisë pa afate ligjore;
 - (ii) efekti i një vendimi të formës së prerë gjyqësor është se i njëjti bëhet i ekzekutueshëm, por mund të jetë subjekt i shtyrjes apo ndërprerjes së ekzekutimit me vendim gjykate nëse plotësohen kushtet ligjore;
 - (iii) kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet në rastet e shkeljes së ligjit material dhe procedural, por jo për konstatim të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike;
 - (iv) kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e hapur (a) si për të pandehurin; ashtu edhe për (b) prokurorinë e shtetit; dhe se
 - (v) Gjykata Supreme ka juridiksion që të vërtetojë ose të ndryshojë vendimin e formës së prerë, të kthejë rastin në rigjykim ose të shpallë vendim deklarativ.
179. Në vijim të kësaj, Gjykata vlerëson se një vendim penal bëhet përfundimtar, në kuptimin *res-judicata*, për qëllim të nenit 34 të Kushtetutës dhe nenit 4 të Protokollit 7 të KEDNJ-së, kur ligji nuk përcakton mjet juridik sipas legjislacionit në fuqi për ta kundërshtuar atë; ose kur nuk ushtrohet mjetet juridike të përcaktuara me ligj brenda afateve të përcaktuara ligjore, qoftë nga i pandehuri, qoftë nga ana e prokurorit; ose kur të njëjtin e konfirmon nga instanca më e lartë gjyqësore.
180. Për më tepër, Komisioni i Venecias ka theksuar se parimi *res judicata* nënkupton se kur një ankesë është gjykuar përfundimisht, ankesat e mëtejme nuk janë të mundura. Aktgjykimet përfundimtare duhet të respektohen, përveç nëse ka arsye bindëse për rishikimin e tyre (shih *Përmbledhjen e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias lidhur me Sigurinë Juridike*, [CDL-PI(2022)004] të 21 marsit 2022, paragrafi 63).
181. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet edhe rastit të saj KO95/20, në të cilin rast kontestuese ishte nëse në ditën e votimit njëri nga deputet ishe i dënuar për vepër penale,

me ç'rast Gjykata kishte konstatuar se i njëjti (i) "ishte dënuar për vepër penale me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit", si dhe (ii) "kishte pranuar vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit dhe vendimin përfundimtar të Gjykatës Supreme", duke vënë theksin në vendimin përfundimtar të Gjykatës Supreme (shih rastin e Gjykatës [KO95/20](#), me parashtrues *Liburn Aliu dhe 16 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 21 dhjetorit 2020, paragrafi 253).

182. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se në përmbajtje, pavarësisht emërimit dhe për qëllim të definimit të natyrës dhe fushëveprimit të saj bazuar në parimet e nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është një ankesë për çështje ligji (material dhe procedural) që, në parim, nuk e ndal ekzekutimin, dhe që vlerëson ligjshmërinë e vendimeve të instancave me të ulëta. Lidhur me këtë, sipas KPPRK-së, Gjykata Supreme ka juridiksion të plotë që të konfirmojë, ndryshoj apo rikthej rastin në rigjykim në gjykatat më të ulëta, dhe me këtë rast, vendimi i saj është përfundimtar.
183. Prandaj, Gjykata vlerëson se nga vet natyra e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë rezulton se kjo e fundit përfshihet si "mjet i jashtëzakonshëm juridik" sipas emërimit të KPPRK-së, por është vazhdimësi e të njëjtës procedurë penale që ka rezultuar në vendim të formës së prerë, i cili vendim bëhet *res-judicata* për qëllim të parimit *ne bis in idem*, të përcaktuar në nenin 34 të Kushtetutës dhe nenit 4 të Protokollit nr.7 të KEDNJ-së, (i) nuk kontestohet në Gjykatën Supreme përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë ose kalojnë afatet për një gjë të tillë; ose (ii) pas vendimit të Gjykatës Supreme, nëse një kërkesë e tillë është bërë. Në këtë aspekt, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë ka të bëjë me pretendime për shkelje ligjore që kanë ndodhur në procedurat në shkallë më të ulëta, dhe nuk ka të bëjë me zbulimin e fakteve të reja të panjohura më parë.
184. Për më tepër, Gjykata vlerëson se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, pavarësisht emërimit, plotëson kriteret e përcaktuara nga GJEDNJ përkitazi me sigurinë juridike, pasi e njëjta:
- (i) është e hapur si për të pandehurin ashtu edhe për prokurorinë;
 - (ii) është e kufizuar në kohë, përkatësisht mund të paraqitet vetëm brenda tre (3) muajve nga data e pranimit të vendimit të formës së prerë;
 - (iii) juridiksioni i Gjykatës Supreme përkitazi me këtë mjet juridik është i qartë sa i përket shkeljeve që mund të ngritën përfshirë ligjin material dhe procedural, dhe faktit që i njëjti nuk mund të paraqitet për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike;
 - (iv) është vazhdimësi e procedurës së shkallëve më të ulëta dhe nuk shqyrton faktet e reja që nuk janë trajtuar më herët në procedurë;
 - (v) dispozitat e KPPRK-së përcaktojnë qartë efektet e vendimmarrjes në Gjykatën Supreme me ç'rast kjo e fundit mund të vendos vetëm në dobi të të pandehurit, përveç nëse vendimi i formës së prerë "është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë".
185. Bazuar në elaborimin dhe sqarimin si më sipër nuk mund të konstatohet që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë bie në fushëveprimin e nenit 4 të Protokollit nr.7 të KEDNJ-së, pasi para vendimit të Gjykata Supreme në kuadër të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, personi nuk ka qenë i dënuar ose i liruar me vendim që është *res-judicata* për një vepër penale, sipas parimeve të përcaktuara nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së.
186. Rrjedhimisht, në rastin konkret, Gjykata vlerëson se nuk mund të zbatohen garancitë e përcaktuara në nenin 4 të Protokollit nr.7 të KEDNJ-së.
187. Për më tepër, Gjykata gjithashtu vëren se, për dallim nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, Kodi i Procedurës Penale kërkesën e rishikimit të procedurës e ka përcaktuar si mjet të veçantë juridik.

188. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet nenit 422 (Rishikimi i procedurës penale të pushuar me aktvendim të formës së prerë) dhe nenit 423 (Rishikimi i procedurës penale të përfunduar me aktgjykim të formës së prerë) të KPPRK-së, e që ndërlidhen me rastet kur kemi të bëjmë me rihapje të procedurës, përkatësisht nëse kemi të bëjmë, ndër të tjera, me (i) kryerje të veprave penale nga ana e prokurorit të shtetit, përkatësisht gjyqtarit; (ii) kur aktgjykimi është mbështetur në dokumente të falsifikuara; ose (iii) nëse zbulohen fakte të reja. Ky mjet juridik, për dallim nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, bie qartësisht në fushëveprimin e nenit 4 të Protokollit nr. 7, pasi i njëjti rihap rastin e vendosur me vendim të formës së prerë ose me vendim *res-judicata*, dhe i nënshtrohet rishqyrtimit të tij, bazuar në faktet dhe rrethanat e reja dhe me afate të gjata kohore, deri në (5) vjet, kur një mjet juridik i tillë mund të përdoret.
189. Në këtë kontekst, konkluzioni i lartcekur ndërlidhet me rastet që janë parashtruar para Gjykatës e që kanë të bëjnë me vendimin për hedhje të aktakuzës dhe vendimin për përfundimin e procedurës penale. Ndërsa sa i përket rasteve të paraburgimit, duhet ritheksuar se në ato raste gjithashtu nuk kemi vendim përfundimtar edhe sa i përket *“lirimit apo dënimit”* për vepër penale pasi ajo është procedurë që ndërlidhet vetëm me sigurimin e prezencës së të pandehurve në procedurë penale e cila është në zhvillim e sipër.
190. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata referuese po ashtu kërkon nga Gjykata që të sqarojë termin e përdorur në paragrafin 2 të nenit 438 të KPPRK-së *“qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë”*, pasi kjo mund të shkaktojë paqartësi në interpretim; duke ngritur pyetjen se si duhet të veprojë kjo e fundit pasi ka konstatuar se bëhet fjalë për një *“vendim qartazi të papërshtatshëm ose të bazuar në gabim të rëndë”*.
191. Gjykata rikujton se paragrafi 2 i nenit 438, duhet interpretuar në kuadër të garancive procedurale të përcaktuara në nenet 29 dhe 31 të Kushtetutës dhe nenet 5 dhe 6 të KEDNJ-së, respektivisht si dhe në kuadër të garancive të tjera që mund të afektojnë të drejtat dhe liritë e të pandehurit, të cilat janë të mishëruara në Kushtetutë, dhe përgjatë gjithë dispozitave të vet KPPRK-së. Prandaj gjatë interpretimit të termit *“qartazi të papërshtatshëm”* ose *“gabim të rëndë”*, Gjykata Supreme duhet të ketë parasysh normat kushtetuese, përfshirë nenit 53 të Kushtetutës që përcakton se interpretimi i të drejtave të njeriut bëhet në pajtim me vendimet e GJEDNJ-së, detyrim ky që vlen për të gjitha gjykatat, përfshirë edhe Gjykatën Supreme.
192. Në këtë aspekt, sa i përket sigurisë juridike, Komisioni i Venecias ka theksuar se është *“thelbësore për besimin në sistemin gjyqësor dhe sundimin e ligjit”*, çka kërkon që rregullat ligjore të jenë të qarta dhe precize, dhe se kanë për qëllim që situatat dhe marrëdhëniet ligjore të mbesin të parashikueshme (shih *Opinionin e Komisionit të Venecias mbi draft-ligjin për amendamentet dhe shtesat në kodin gjyqësor të Armenisë*, [CDL-AD(2014) 021], e 16 qershorit 2013, paragrafi 18).
193. Lidhur me këtë Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së se shprehja *“në pajtim me ligjin”* kërkon jo vetëm që masa e ndërmarrë të ketë bazë në të drejtën vendore, por gjithashtu i referohet edhe kualitetit të ligjit në fjalë, duke kërkuar që i njëjti të jetë i qasshëm për personat që i'u referohet dhe i parashikueshëm sa i përket efekteve. Njëra nga kërkesat që rezulton nga shprehja *“në pajtim me ligjin”* është parashikueshmëria. Andaj një normë nuk mund të cilësohet *“ligj”*, përderisa nuk formulohet me precizitet dhe qartësi të duhur që t'u mundësojë subjekteve juridike që të rregullojnë sjelljen e tyre. Andaj, ata duhet të jenë në gjendje, nëse është e nevojshme me këshillat e duhura, të parashohin, në një nivel që është i arsyeshëm brenda rrethanave, pasojat që një veprim mund të ketë. Megjithatë, sipas GJEDNJ-së, këto pasoja nuk duhet të jenë të parashikuara më një precizitet absolut, pasi përvoja ka treguar që një gjë e tillë është e paarritshme. (shih rastin

e GJEDNJ-së, [Tommasi kundër Italisë](#), nr, 43395/09, Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafët 106 dhe 107).

194. Lidhur me të lartcekurat Gjykata thekson se neni 438 i KPPRK-së përcakton se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur në dëm të të pandehurit nëse është e bazuar, në parim, ka vetëm efekt deklarativ. Përfundimisht e njëjta mund të ketë efekt edhe në dëm të të pandehurit, nëse vendimi i formës së prerë është *“qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë”*.
195. Prandaj, siç sugjeron edhe vet terminologjia e përdorur nga ligjvënësi, vendosja në dëm të të pandehurit, vjen në shprehje vetëm në raste shumë përjashtimore kur kemi të bëjmë me një vendim *“qartazi të papërshtatshëm”* apo të bazuar në *“gabim të rëndë”*. Në këtë aspekt, duhet theksuar qartë që dy këto baza, domosdoshmërisht ngërthejnë shkelje serioze ligjore, procedurale apo materiale, të cilat e vënë në pikëpyetje integritetin e vendimmarrjes që ka rezultuar në vendim të formës së prerë. Gjykata po ashtu thekson se çdo vendimmarrje e tillë, përfshirë bazuar në mekanizmat ligjorë për të siguruar konsistencë në praktikën e saj gjyqësore, në dëm të të pandehurit duhet të jenë në përputhje të plotë me të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutë, praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe dispozitat e tjera të KPPRK-së, ashtu siç do të sqarohet në vijim.
196. Prandaj, Gjykata vlerëson që këto përjashtime mund të zbatohen vetëm në raste të shkeljeve serioze të ligjit nga gjykatat më të ulëta, sipas sqarimeve të lartcekura. Në rrethana të tjera, Gjykata Supreme, duhet t'i përmbahet parimit që vendimi në dëm të të pandehurit, ka vetëm efekt deklarativ.
197. Gjykata po ashtu thekson se, përcaktimi në paragrafin 2 të nenit 438 të KPPRK-së që vendimmarrja në Gjykatës Supreme nëse është në dëm të të pandehurit të ketë vetëm efekt deklarativ, duhet të vjen në shprehje aq më tepër në raste të paraburgimit, me ç'rast, ashtu siç thekson edhe vet Gjykata Supreme, *“drejta për liri dhe siguri duhet të interpretohet në favor të qëndrimit në liri dhe kjo masë (si masë më e rëndë) duhet të reduktohet në kohën sa më të shkurtër të mundshëm”*.
198. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se ashtu siç është theksuar edhe në praktikën e saj gjyqësore, gjykatat e rregullta, përfshirë Gjykatën Supreme, kanë të drejtë dhe për më tepër obligim që gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjykojnë, fillimisht sipas Kushtetutës, e pastaj sipas ligjit (shih rastin e Gjykatës [KI207/19](#), me parashtrues *Nisma Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 124). Thënë këtë, edhe Gjykata Supreme është e obliguar që përveç të drejtave procedurale të të pandehurve të përcaktuara në KPPRK, duhet të kujdeset edhe për të drejtat themelore të përcaktuara me Kushtetutë e KEDNJ, përfshirë të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm i garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe të drejtën për liri dhe siguri të përcaktuar në nenin 29 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së.
199. Sa i përket veprimeve që duhet të ndërmerret Gjykata Supreme në ato raste kur duhet të vendosë në dëm të të pandehurve, Gjykata rikujton se bazuar në paragrafin 1 të nenit 438 të KPPRK-së, kur Gjykata Supreme vërteton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, merr aktgjykim me të cilin, duke pasur parasysh llojin e shkeljes ajo mund të (i) ndryshojë vendimin e formës së prerë; ose (ii) në tërësi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë dhe e kthen rastin në rigjykim.
200. Lidhur me këtë Gjykata rikujton rastin e saj KI104/16, në të cilin kishte konstatuar se duke mos e ftuar parashtruesin e kërkesës të jetë i pranishëm në seancën e Gjykatës së Apelit në të cilën është përcaktuar fajësia e tij, parashtruesit të kërkesës i ishte mohuar mundësia për t'u mbrojtur ndaj akuzave kundër tij. Si rrjedhojë, Gjykata kishte konstatuar se ka

pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6, paragrafët 1 dhe 3, nën (c) dhe (d) të KEDNJ-së (shih rastin e Gjykatës [KI104/16](#), me parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 29 majit 2017).

201. Në këtë aspekt, Gjykata edhe në rastin konkret thekson se, edhe në kuptim të sigurisë juridike përfshirë parashikueshmërinë dhe konsistencës së vendimmarrjes, i takon Gjykatës Supreme që gjatë vendimmarrjes së saj, përveç që duhet të jetë konsistente në mënyrën e zbatimit të përjashtimit të lartcekur "*qartazi i papërshtatshëm apo i bazuar në gabim të rëndë*", që ajo po ashtu, siç është edhe qëllimi i kësaj norme, vetëm përjashtimisht të vendos edhe në dëm të të pandehurve. Lidhur me këtë, i takon asaj po ashtu që të përdorë, nëse kjo është e nevojshme, edhe mekanizmat ligjor për të siguruar konsistencë në praktikën e saj gjyqësore.
202. Po ashtu, Gjykata vlerëson se i takon Gjykatës Supreme që në rast se përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, konsideron se vendimi i kontestuar është "*qartazi i papërshtatshëm apo i bazuar në gabim të rëndë*", ajo është e detyruar që t'i ofrojë palëve të gjitha garancitë procedurale të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Më saktësisht, në përcaktimin nëse e njëjta, (i) ndryshon vendimin e formës së prerë; apo (ii) në tërësi ose pjesërisht e anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë dhe e kthen rastin në rigjykim, ajo duhet të bëjë ato zgjidhje ligjore që konsideron që sigurojnë të drejtat e të pandehurve në procedurë, ashtu siç garantohen me Kushtetutë, KEDNJ dhe KPPRK, me theks në parimet e të drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 i KEDNJ-së, që përcaktojnë, mes tjerash, (i) të drejtën për t'u dëgjuar; (ii) parimin e "*kontradiktoritetit*" dhe të "*barazisë së armëve*"; dhe (iii) të drejtën për mjete juridike dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave. I takon Gjykatës Supreme që gjithashtu, kur kjo është e nevojshme, që të merr parasysht edhe paragrafin 2 të nenit 3 (Prezumimi i pafajësisë së të pandehurit dhe *In Dubio Pro Reo*) të KPPRK-së që përcakton se "*Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.*"
203. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se vendimmarrja e Gjykatës Supreme përfshirë për çështjet e ngritura më lart, mund t'i nënshtrohet vlerësimit kushtetuese sipas kërkesës së palëve të autorizuara, bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 (Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara) të Kushtetutës.
204. Bazuar në sa më sipër, dhe bazuar në garancitë procedurale që duhet siguruar gjatë zbatimit të dispozitave të kontestuara të KPPRK, përfshirë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata konstaton që paragrafi 2 i nenit 4 (Ne Bis In Idem); si dhe formulimi "*përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*" nga paragrafi 2 i nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, nuk janë në kundërshtim me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në lidhje me nenin 4 (2) (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 113.8 dhe 116 të Kushtetutës, nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit dhe në bazë të rregullave 75 dhe 48 (1) (a) të Rregullores së punës, më 15 maj 2024:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, njëzëri, se formulimi “ose ndërprerjen” i paragrafit 4 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, nuk është në kundërshtim me pikën 2 të paragrafit 1 të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË KONSTATOJË, njëzëri, se paragrafi 2 i nenit 4 (Ne Bis In Idem) të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale nuk është në kundërshtim me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 2 të nenit 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- IV. TË KONSTATOJË, me pesë (5) vota për dhe katër (4) kundër, se formulimi “përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë” i paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të Kodit nr.08/L-032 të Procedurës Penale, nuk është në kundërshtim me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 2 të nenit 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- V. T’UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VI. TË KONSTATOJË që Aktgjykimi hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit.

Gjyqtari që përgatiti Aktgjykimin


Jeton Bytyqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani